



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Nëntor 2009 • Viti XXVI • Nr. 11 (181) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3\$FR, SHBA \$2.50



Veprat kryesore të famulltarit të Arsit

FAQE 8

(NGA LETRA E GJON PALIT II DREJTUAR MESHTARËVE)



Karizma e Shën Françeskut të Asizit

FAQE 10-11

Shkruan:
M. VERA PALUCA



Edukimi për dashuri

FAQE 17

Shkruan:
MIHÁLY SZENTMÁRTONI



Koha e Ardhjes - lartësim i shpirtit tonë kah Zoti

■ SHKRUAN:
Patër Anton NUA

Me këtë të diele fillon viti i ri liturgjik, e, njëkohësisht, fillon rrugëtimi ynë kah Krishtlindja. I shkojmë në takim Atij që na vjen. Fjala e Zotit na frymëzon se si duhet të sillemi në këtë kohë të shenjtë. Kah ti, o Zot, po e lartësoj shpirtin tim.

Ndërsa Krishti në ungjill na thotë: Drejtohuni e ngrini kokat, sepse po afrohet shëlbimi juaj. Koha e ardhjes duhet të fillojë me lartësimin e shpirtit tonë kah Zoti. Kjo kohë na thotë dhe na qorton se duhet të harrojmë atë që ka kaluar e të kthehemi ka e ardhmja, kah përjetimi i ri i mëshirës së Zotit, sepse pas ardhjes së Jezusit çdo vit i ri liturgjik quhet dhe është viti i mëshirës.

Edhe sot, si në çdo kohë, pyetja e të qenurit është problemi kryesor i jetës së njeriut. Çdo njeri i përgjigjet kësaj pyetjeje sipas dëshirës tij, në të kundërtën jeta e tij nuk do të kishte kuptim. Gjatë historisë njerëzit kanë dhënë përgjigje të ndryshme mbi këtë çështje. Një ndër këto e jep edhe Bibla. Por duke parë realitetin, se edhe sot shumë njerëz janë të pakënaqur me jetën e tyre, për të cilët jeta nuk ka kuptim, ose jetojnë pa përgjegjësi totale, ose në dyshime; mbarojnë me vetëvrasje; na shtyn tek përfundimi se këto përgjigje ose nuk janë të vërteta ose janë të pajetë, duke e marrë edhe atë të Biblës. Ne ndryshe nuk mund ta kuptojmë këtë rritje të ankthit që rrjedh nga ndjenjat se bota dhe jeta nuk kanë kuptim.

Bibla na dëshmon se si jeta, si kjo botë, kanë kuptim, por nuk është e lehtë për ta zbuluar dhe për ta përvetësuar, sepse kërkon shumë vullnet, punë, flimje, dashuri.

Këtë problem në mënyrë teorike edhe nuk është rëndë për ta zëbërthyer. Bibla na thotë se e tërë gjithësia është vepër e mirësisë dhe e urtisë së Zotit, dhe, mu për këtë arsye, për njeriun është e pranueshme, dhe pas një jete të denjë për Zotin, njeriun e pret lumturia e amshuar me Zotin. Mirëpo, duke parë dhe përjetuar se situata reale e kësaj bote është krejt tjetër, e, më së pakti lumturi, atëherë bie poshtë kjo zgjidhje e shpejtë teorike. Nën shtypjen e kësaj barre na ndihmon një fjalë e Krishtit - Rrini zgjuar. Kjo thirrje prek çdo segment të jetës, të botës, dhe është permanente. Pra, jo të flemë, por të përgatitemi. Në faqet e Biblës e dëgjojmë këtë thirrje 2600 vjet, nga zëri i Isaisë Profet. Zoti do të vijë, jini gati. Po nga këto faqe e dëgjojmë edhe zërin e Gjon Pagëzuesit - Zotin e keni para dere, përgatitni shpirtërat, pastroni zemrat, ndërroni jetën.

Liturgjia e kohës së ardhjes na thërrret që të përgatitemi për tri ardhje: ardhja historike e Shëlbuesit para 2000 vjetëve, ardhja e Shëlbuesit në çdo meshë, dhe ardhja e Tij në lavdi në ditën e fundit. Kisha, duke na përgatitur për Krishtlindje, dëshiron të na përgatisë për Krishtlindjen e amshuar. Pra, Bibla e shpreh mbështetësin e çdo kuptimi të jetës, të botës, të çdo gjëje në Krishtin, sepse nëpër KRISHTIN, Zoti na e dëfton rrjedhën e mbarë historisë deri në përfundim. Kush e shikon Krishtin mund ta shohë se si duket njeriu, i cili e ka kaluar rrugën e zhvillimit dhe, sipas mendimit të Zotit, e ka arritur cakun. Pasi kjo ka ndodhur në këtë histori, e cila ende vazhdon, kjo ndodhi është bërë për ne një shtytje për jetë. Pra, kuptimi mbështetet në të tashmen, por nuk mund ta shikojmë duke ndenjur duarkryq, por do ta shohim në vendimet tona të prera.

Duke ju dëshiruar një nxitje të re nga Fjala e Zotit gjatë kësaj kohe të shenjtë, kah Ai që na e dhuron kuptimin e jetës dhe çdo gjëje që na rrethon, ju them: EMANUEL Zoti me ne.

Përkujtojmë tri data historike për Gjeçovin

FAQE 14

Shkruan:
Prof. Ismet ELEZI

Intervistë me Age Bojaxhiu-Guttadauro-n, mbesë e Nënës Tereze

E privilegjuar dhe krenare për hallën time - Nënën Tereze

FAQE 12-13



Takimi i meshtarëve dhe murgeshave të Kosovës me Nuncin Apostolik Mons. Orlando Antonini

■ SHKRUAN:
Don Albert JAKA

Më 5 nëntor 2009, Imzot Dodë Gjergji, ipeshkvi ynë, ka ftuar Nuncin Apostolik në takimin me meshtarë e motrat e nderit. Një vizitë e tillë e përfaqësuesit më të lartë të Selisë së Shenjtë në Prizren, është vlerësuar si një ngjarje e rëndësishme për Kishën Katolike në Kosovë. Imzot Orlando Antonini ka theksuar se para së gjithash falënderon Imzod Dodë Gjergjin dhe të gjithë të pranishmit, për këtë mikpritje kaq të ngrohtë. Pastaj vijoi: "Dua të shpreh gëzimin që jam me ju, për t'iu takuar dhe njohur, për ta përcjellë edhe përshëndetjen e përzemërt të Atit të Shenjtë, Papa Benedikti XVI...".

Ndërkohë që Imzot Dodë Gjergji ka theksuar: "Jemi mbledhur meshtarë e murgesha në Prizren për ta përshëndetur Nuncit të ri." Pastaj kanë përshëndetur edhe meshtarët, të cilët kanë pasur mundësi edhe të bëjnë pyetje e analiza rreth situatës në Kosovë. uncit Apostolik iu ka paraqitur në mënyrë përmbledhëse situata e Kishës Katolike në Kosovë.

Nunci Apostolik e falënderoi Ipeshkvin për pritjen dhe u shpreh jashtëzakonisht i impresionuar nga aktivitetet e ndryshme që zhvillojnë meshtarët e motrat nëpër famulli, edhe pse jemi një bashkësi e vogël numerikisht, jemi një Kishë e gjallë dhe aktive.

Në ora 12.00 u kremtua Mesa Shenjte në Konkatedralen "Zoja Ndihmëtare". Meshën Shenjte e udhëhoqi Nunci Apo-

sotolik Sh.T. Mons. Orlando Antonini, së bashku me Ipeshvin tonë, meshtarët e dioqezës dhe rregulltarët e rregulltarët, si dhe besimtarët e shumtë.

Dreka vëllazërore mbylli ditën e këtij takimi, që me të vërtetë la mbresa për të gjithë pjesëmarrësit.

Pas Prizrenit, Nunci Apostolik i shoqëruar nga ipeshkvi i dioqezës Mons. Dodë Gjergji, ka bërë udhëtimin drejt Prishtinës, ku me ftesë të Ordinarit vendor në Residencën e re të Ipeshkvisë u mbajt Mbledhja e 24-të e Konferencës Ndërkombëtare Ipeshkvnore të "Shën Çirilit e Metodit", seksioni i rregullt vjeshtor.

Në fillim të seancës plenare të Konferencës përshëndeti Presidenti i Republikës së Kosovës Dr. Fatmir Sejdiu dhe ipeshkvi ynë Imzot Dodë Gjergji.

Në Mbledhjen dyditore, ipeshkvijtë kanë diskutuar mbi situatën e Kishës Katolike në dioqezat që i përfshinë kjo Konferencë dhe kanë kërkuar përgjigje të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetëve dhe misionit ungjillor. Fjalimin e hapjes e bëri Nunci Apostolik, Mons. Orlando Antonini.

Në një mënyrë të veçantë kanë diskutuar rreth mundësisë së kryerjes së detyrave në Kishat tona, sipas udhëzimeve të Papa Benediktit XVI të shprehura në Enciklikën e re "Caritas in veritate". Ipeshkvijtë iu bëjnë thirrje të gjithë priftërinjve, murgeshave dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë, që të përipiqemi për të ndërtuar një të ardhme të re, që bazohet në qytetërimin e dashurisë dhe të së vërtetës. Po ashtu, ai inkurajoi meshtarët, veçanë-

Mons. Dodë Gjergji, Mons. Orlando Antonini, Don Lush Gjergji gjatë takimit me meshtarët dhe murgeshat e Kosovës



Mons. Orlando Antonini dhe Mons. Dodë Gjergji me seminaristët



Ipeshvijnjtë e Konferencës "Shën Çirili e Metodi" së bashku me Presidentin e Kosovës, Prof. Dr. Fatmir Sejdiun

isht në këtë "Vit meshtarak", që ta jetësojnë dhe dëshmon gjithnjë e më mirë thirrjen e tyre meshtarake.

Duke pasur parasysh misionin e Kishës dhe nevojat e kohës së sotme, ipeshkvijtë ftojnë popullin për t'u lutur në mënyrë që në këtë rajon, ku kemi sprovuar hidhërimin e urrejtjes dhe konfliktin, të gjejmë mundësi faljeje dhe pajtimi në mes të gjithë popujve, që të gjithë të mund të jetojnë në paqe dhe duke ndërtuar një të ardhme të sigurt, që mund të arrihet vetëm nëpërmjet dashurisë dhe faljes.

Duke iu përgjigjur sfidave të kohës në këto fusha, ne ftojmë të gjithë përgjegjësitë, që të kuptojnë frymën autentike të bashkimit evropian - në vend

të sekularizmit të dhunshëm dhe relativizmit agresiv - t'iu mundësojmë të gjithë banorëve të rajonit tonë në rrjedhën normale të procesit të integritimit në familjen e madhe evropiane. Me këtë do t'i japim popullit tonë një kontribut të pazëvendësueshëm për qytetërimin e kulturën evropiane, e sidomos atë shpirtërore.

Një falënderim i veçantë i shkon Atit të Shenjtë Benedikti XVI, i cili kujdeset për nevojat tona si një baba dhe duke na ndihmuar për të tejkaluar të gjitha vështirësitë me të cilat Kisha jonë lokale përballët gjithnjë. Ne jemi gjithmonë afër Papës nëpërmjet përfaqësuesit të tij, Nunci Apostolik.

Ndërrimet e meshtarëve 2009

Në këtë vit në ipeshkvinë tonë, për motive pastorale, për të mirën e kishës dhe të besimtarëve, është kërkuar nevoja e disa ndërrimeve të meshtarëve këtu në Kosovë dhe jashtë ipeshkvisë. Këto ndërrime kanë përfshirë një grup meshtarësh dhe kjo është vala e dytë e ndërrimeve, prej kur në ipeshkvinë tonë erdhi ipeshkvi i ri Mons. Dodë Gjergji.

Vala e dytë e ndërrimeve të meshtarëve ka arritur, falë këtyre motiveve: ndërtimi dhe përuimi i qendrës së re pastorale në Prishtinë (Ordinariatit Ipeshkvor), kthimit të tre meshtarëve nga shërbimi i tyre Fidei Donum në Argjipeshkvinë e Tivarit dhe ardhja e meshtarit të ri dhe xhakonave në ipeshkvinë tonë. Kështu që ndërrimet janë bërë në këtë mënyrë si vijon:



- **Don Franë Kola**, ish delegat i përgjithshëm dhe famullitar i famullisë së "shën Nikollës" në Velezhë, tani e tutje do të shërbejë në Misionin Katolik Shqiptar në Sirmach - Zvicër.



- **Don Shan Zefi**, ishte administrator në famullinë "Zoja e Hasit" në Zym, tani merr detyrën e administratorit të famullisë "Shën Antonit", në Prishtinë, më banim në qendrën e re.



- **Don Agim Qerkini**, lirohet nga detyra e sekretarit të Ipeshkvit dhe emërohet misionar në Misionin Katolik Shqiptar në Zagreb - Kroaci.



- **Don Marjan Marku**, nga Misioni Katolik Shqiptar në Sirmach -Zvicër, emërohet famullitar në famullinë e shën Nikollës në Velezhë.



- **Don Jeton Thaqi** ish vikar në famullinë e "shën Nikollës" në Velezhë emërohet po ashtu vikar në famullinë "Zoja Ndihmëtare" në Prizren.



- **Don Lush Gjergji**, lirohet nga detyra e famullitarit të Prizrenit dhe emërohet delegat i përgjithshëm me banim në qendrën e re në Prishtinë.



- **Don Albert Jakaj** nga shërbimi i tij në argjipeshkvinë e Tivarit, emërohet sekretar i Ipeshkvit më banim në Prishtinë.



- **Don Aleksandër Kola**, deri tani famullitar në Stubëll, tani emërohet famullitar i famullisë "Zoja Ndihmëtare" në Katedralen e Prizrenit.



- **Don Ndue Ballabani** lirohet nga detyra e misionit katolik shqiptar në Zagreb - Kroaci dhe emërohet administrator në famullinë "Zoja e Hasit" në Zym.



- **Don Herbert Berisha**, ishte administrator i famullisë së "shën Kryqës" në Gllaviçicë, tani emërohet famullitar në famullinë e "shën Jozefit" në Stubëll.



- **Don Robert Jakaj** nga shërbimi i tij në argjipeshkvinë e Tivarit, emërohet për përkujdesje të Karavansarisë dhe të Llapushnikut me banim në Zllakuqan.



- **Don Pal Tunaj**, ishte vikar në famullinë "Zoja e Këshillit të Mirë" në Klinë, tani emërohet administrator i famullisë së "shën Kryqës" në Gllaviçicë.



- **Don Nikson Shabani** nga shërbimi i tij në argjipeshkvinë e Tivarit, tani përgjegjës për zyrën e katekumenëve në Prishtinë.



- **Don Marjan D. Ukaj**, meshtar i ri, emërohet vikar në famullinë "Zoja e Këshillit të Mirë" në Klinë



- **Martin Jetishi**, xhakon, për një kohë do të shërbejë në Novosellë.



- **Kastriot Idrizi**, xhakon, për një kohë do të shërbejë në Velezhë.

Redaksia e "Dritës" këtyre meshtarëve, si dhe bashkësisë së Salezianëve të cilët kanë hapur qendrën e re në qytetin e Gllanit, u uron shëndet, mbarësi dhe shumë suksese në punët e reja nëpër famullitë dhe angazhimet që ipeshkvi ua ka besuar. Zoti e përcjellë gjithnjë punën e juaj dhe i shumëzoftë frytet e saja. Urime!

(Dritapress)

Këshilli organizativ i Kosovës për 100-vjetorin e lindjes së Nënës Tereze

Më 11 nëntor 2009 në Prishtinë është mbajtur takimi i parë konstitutiv i Këshillit Organizativ të Kosovës për 100-vjetorin e lindjes së të Lumes Nënës Tereze /2010/. Në këtë takim punë morën pjesë: Valtan BEQIRI, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Xhavit BEQIRI, përfaqësues i Presidencës, Ali PODRIMJA, përfaqësues i Akademisë së Shkencës dhe Arteve, Jusuf BAJRAKTARI, përfaqësues i Institutit të Historisë, Don Lush GJERGJI, përfaqësues i Kishës Katolike.

Ky Vit Jubilar do të hapet më 10 dhjetor 2009, me rastin e 30-vjetorit të marrjes së Shpëblimit Nobel për Paqe të Nënës Tereze në Oslo - Norvegji /10 dhjetor 1979- 10 dhjetor 2009/.

Gjatë vitit 2010 janë paraparë manifestime të ndryshme kulturore dhe shpirtërore, me pjesëmarrje të botës së shkencës, kulturës, artit, ku parashihen botime të librave, pjesë teatrale, muzikore, java e filmit dokumentar kushtuar Nënës Tereze, si dhe seminare, simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i këtyre veprimtarive është ky: ndriçimi i jetës dhe veprës së saj në dimensionet botërore, si dhe ndër shqiptarë, si dhe krijimi i kulturës së jetës dhe qytetërimit të dashurisë, shtylla këto të tërë veprimtarisë së saj të mbështetur në të vërtetë dhe në dashuri për Zotin dhe Njeriun, veçmas për të varfër dhe të rrezikuar.

Dita qendrore do të jetë në

Prishtinë më 5 shtator 2010, festa e së Lumes Nënës Tereze, ku parashihet edhe Mesha e Parë dhe bekimi i Katedrales dhe Shenjtërores në ndërtim me titull “Nëna Tereze”, me pjesëmarrje të autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare.

Veprimtaritë e tillë përforcojnë dhe begatojnë vëllazërinë gjithëshqiptare të Kosovës me Shqipërinë dhe Maqedoninë, si dhe me vendet tjera, duke krijuar kulturën e takimeve dhe të dialogut ndërnjerëzore, zhvillimin e paqes, bashkimit në dallime, bashkëjetesës dhe faljes, gjithnjë në stilin e Nënës së Madhe – Nënës Tereze.

(Dritapress)

Takimi i Rregulltarëve dhe Rregulltareve të Kosovës (URrK)

Binçë 14.11.2009

Në këtë takim të URrK-së pati pjesëtarë të të gjitha bashkësive rregulltare që veprojnë në Kosovë. Ligjëratën e mbajti don Lush Sopë, duke u bazuar në temën qendrore të vitit meshtarak. Na e paraqiti në mënyrë të shkëlqyeshme figurën dominante të këtij viti – shën Gjon Vijnaneun. Foli për jetën e këtij shenjtë ku ceku dashurinë e tij ndaj të Shenjtërueshmit Sakrament, zellin për të punuar në vreshtin e Zotit. Përkundër vështirësive që kishte për të mbajtur mend. Ai tërë jetën e kaloi duke i shërbyer Zotit me dashuri dhe përshpiti. E kur kishte sukses pas suksesi nuk krenoej, duke ditur se çdo e mirë

vjen prej Zotit. Thellë në zemër i mbante fjalët e Krishtit: “Pa mua nuk mund të bëni asgjë.”

Kulmi i këtij takimi ishte mesha shenjte, të cilës i parapriu don Dominiku, ku bashkëmëshuan edhe rregulltarët tjerë të pranishëm. Në fund të meshës iu shpërndanë të gjitha motrave, emrat e meshtarëve të Ipeshkvisë së Kosovës. Çdonjërë motër do të lutet në mënyrë të veçantë për meshtarin që i ka takuar të lutet.

Pas agape-s u shqyrtua puna e bërë në grupe dhe kështu duke u pasuruar me mendimet e secilit pjesëmarrës e përfundam këtë takim.

m. Dominika Gjergjaj

Simpozium Shkencor “Filipaj dhe Bibla shqip,”



DON SIMON FILIPAJ Biografia

Don Simon Filipaj u lind më 1 Maj të vitit 1925 në fshatin Kllezën e Poshtme, afër Shasit të lashtë të komunës së Ulqinit, në Malin e Zi. Më 1932 filloi shkollën fillore dyvjeçare në Selitë, për të vazhduar arsimimin e tij në Katërkollë afër Ulqinit.

Seminarin që i hapi rrugën e meshtarisë e kreu për disa vite në Tivar (1939-1941) dhe e vazhdoi pranë Seminarit Jezuit në Shkodër (1941-1945). Në vitet 1946-1950 Filipaj kreu studimet filozofike - teologjike në Fakultetin Teologjik të Zagrebit. Po në këtë vend u shuguroi meshtar më 29 Qershor 1950, si anëtar i Kryedioqezës së Tivarit.

Fillimet e jetës klerikale Filipaj i kaloi në Triepsh e në Kojë të Kuçit (1950-1960), kurse në vitet 1960-1966 në Grudë të Malësisë së Madhe. Pjesën më të madhe të shërbimit, 33 vjet, ai e ka kryer në Shëngjergj dhe në Killezë, buzë lumit Buna, nga 20 nëntori 1966 deri më 2 shtator 1999, kur dhe ndërroi jetë.

Për kontributin e dhënë për kishën katolike ndër shqiptarë, më 3 nëntor 1988 Selia e Shëngjergjit i dha Filipajt titullin e lartë “Imzot” (Monsinjon), ndërsa më 6 korrik 1992 u shpall “Prelat Nderi” nga Papa Gjon Pali II. Për kontributin e tij në dobi të kulturës shqiptare, më 2004 (pas vdekjes) u dekorua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, me urdhërin “Naim Frashëri i Artë”.

Qendra e studimeve albanologjike e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin Filozofik- Teologjik të Shkodrës organizuan më 11 nëntor në Muzeun Historik Kombëtar të Tiranës, simpoziumin shkencor “Filipaj dhe Bibla shqip” kushtuar veprës së Don Simon Filipajt (1925-1999). Më këtë rast u lexuan këto kumtesa nga të pranishmit:

- Prof. Ardian Marashi: Bibla, matricë e leximit dhe e interpretimit të

- botës;
- Dr. Don Nikë Ukgjini: Dekada e dëshmisë së Filipajt;
- Prof. Kolec Topalli: Përkthime të Biblës në ballafaqim: nga Buzuuku te Filipaj;
- Prof. Xhevat Lloshi: Një përvojë e re: përkthimi besnik i domethënies;
- Zefan Nikolli: Probleme dhe vështirësi në përkthimin e Biblës;
- Prof. Shaban Sinani:

- “Kënga e këngëve”; Ma. Evalda Paci: Pasioni i Krishtit: nga Meshari tek Bibla e Dom Simon Filipajt;
- Prof. Alfred Çapaliku: Folkloristi Filipaj dhe tri këngë dashurie;
- Prof. Gjovalin Shkurtaj: Elemente të etnografisë së të folurit në Librat e Shëngjergjit;
- Dr. Don Lush Gjergji: Filipaj, Shën Jeronimi i ditëve tona (e lexoi don

Nikë Ukgjini);

Pas ligjeratave u shfaq filmi dokumentar “Heronjtë e Librit”, skenari Stefan Çapaliku; regjia Tonin Ujka;

Në fund u prezantua një ekspozitë e përgaditur nga don Gabriel Grabanica dhe Jozo Koqoi me dorëshkrimet, dokumentet, objektet dhe fotografit të don Simon Filipajt me rast 10-vjetorit të vdekjes.

Tiranë, 2 nëntor 2009.



Në Vatikan u mbajt Kongresi i gjashtë botëror për baritoren e emigrantëve dhe të refugjatëve

Ishin rreth 300 ekspertë ndërkombëtarë që morën pjesë në Kongresin e gjashtë përbaritorin e emigrantëve dhe të refugjatëve, i cili filloi në Vatikan, me audiencën e Benediktit XVI dhe me mesheën e kremtuar nga kardinali sekretar i shtetit, Tarçizio Bertone. Pasi kërkoj që fenomeni i emigracionit të shihet si mundësi për vëllazërimin ndërmjet popujve e si konfirmim i të drejtave të personave të përfshirë në të, kongresi u përqendrua në temën: "Një baritori e veçantë për të rinjtë e adoleshentët emigrantë e refugjatë". Edhe një herë Kisha është pararendëse e kohës, kur brezi i dytë e emigracionit do të mund të luajë ose një rol pozitiv integrimi kulturash, ose i

pakënaqur nga mënyra si i kanë trajtuar prindërit edhe atë vetë, do të mënjanohej nga shoqëria ku është rritur e do ta luftojë atë. Në audiencë, Papa Benedikti XVI kërkoj që emigrantët të konsiderohen pasuri e jo problem. Janë pa dyshim fjalë shumë të rëndësishme. E kjo, sepse, duke u nisur nga vlera e madhe e personit njerëzor, duhet nënvizuar fakti se emigrant është ai që, me ne e me bashkësitë tona si civile, ashtu edhe kishtarë, është një pasuri për Kishën, është një vëlla, apo një motër. Nga kjo pikëpamje, duhet nënvizuar pikërisht pozitiviteti i pranisë së tyre, që me gjithë vështirësitë e përditshme, ka në bazë mundësinë e pasurimit të ndërsjellë. Gjithsesi, siç tha edhe Papa, kjo duhet bërë përmes dialogut e komunikimit.



Pra, sa është i rëndësishëm një takim si ai që po zhvillohet në Vatikan, ku po bëhen përpjekje edhe për të koordinuar punën për t'i pritur sa më mirë emigrantët? Është e rëndësishme që të jemi në sintoni si në pikëpamje, ashtu edhe në veprimet konkrete: para së gjithash brenda në Kishë e pastaj edhe në shoqëri. Për sa i përket Kishës, duhet të mendojmë për strategji ungjillëzimi, edhe të reja, për t'i shoqëruar emigrantët. Këtu mendohet për katekizmin, jetën liturgjike dhe sakramentale. Këto gjëra, në shumë prej dioqezave italiane, bëhen me impenjim të madh, me inteligjencë, duke i shoqëruar bashkësitë etnike, në mënyrë që rruga e përshkuar të jetë

edhe rrugë bashkëveprimi kishtar. Siç u nënvizua, integrimi është një aspekt kryesor, për të cilin akoma duhen gjetur zgjidhje. Duhet të mbështesim gjithnjë anën pozitive të çështjes e për këtë, fjalët e Papës, që përveç problemeve ekzistuese, nënvizojnë faktin që emigrantët është pasuri, përfaqësojnë një këndvështrim pozitiv, i cili vë në plan të parë pikat e forcës. Për sa i përket solidaritetit, që përfaqëson një vlerë themelore me të cilën është mburitur toka jonë italiane dhe Kisha jonë, mesazhi është të globalizohet solidariteti. Pra, ka vlera që janë pjesë e trashëgimisë sonë historike e duhen propozuar e përsëritur vazhdimisht sipas gjendjes aktuale.

FAO miraton "Pesë parimet e Romës për sigurinë ushqimore"

Krërët e shteteve dhe të qeverive, të mbledhur në Romë për takimin e FAO-s mbi sigurinë ushqimore, miratuan deklaratën me pesë parime, që përcakton impenjimet e luftës globale kundër urisë. Por, dokumenti nuk i përgjigjet kërkesës së sekretarit të përgjithshëm Zhak Diuf, sipas së cilës 44 miliard dollarë duhej të caktoheshin për zhvillimin e bujqësisë. Në deklaratë shprehet alarmi për rritjen e numrit të të uriturve deri në 1 miliard e 200 milion dhe përsëritet impenjimi për ta përgjysmuar atë brenda vitit 2015. Për sa u përket "Pesë parimeve të Romës për sigurinë e qëndrueshme ushqimore", teksti parashtoi se pari:

1. Të investohet në programet e hartuara nga vendet e interesuara;
2. Të forcohet koordinimi në nivel rajonal e global për të përmirësuar qeverisjen,



shpërndarjen e fondeve dhe për të shmangur paralelizmin.

3. Parimi i tretë i deklaratës kërkon të punohet në dy binarë: ndërhyrje të menjëhershme për personat në rrezik e programe afatmesme e afatgjatë për bujqësinë, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin e fshatit.

4. Pika e katërt flet për përmirësimin e punës dhe të koordinimit ndërmjet tri agjencive të OKB-së, që punojnë në fushën e ushqimit dhe të bujqësisë: FAO, IFAD dhe Programi Ushqimor Botëror.

5. Parimi i pestë dhe i fundit ka të bëjë me burimet financiare.

U kërkohej partnerëve të investojnë vazhdimisht në bujqësi e në sigurimin e ushqimit mbi bazën e programeve dhe planeve shumëvjeçare. Shumë liderë politikë do t'i përgjigjen thirrjes së sekretarit të përgjithshëm të FAO-s, Zhak Diuf për të ndënuar një ditë pa ngrenë, në një lloj greve urie për solidaritet me më të varfrit. Por si gjithmonë, impenjime të tilla të OKB-së kanë dy faqe. Tjetra paraqet po këta politikanë në suita luksoze në qendër të Romës, ku paguhet 750 euro nata.

Mbreti Abdullah ia tërheq vërejtjen Khamenit: jo "politizim" pelegrinazhit në Mekë



Mbreti i Arabisë ia bën me dije botës islamike se nuk do të tolerohet asnjë manifestim protestash apo aktivitete të tjera që e qesin në rrezik sigurinë e besimtarëve. Sipas një lajmi është bërë e ditur se udhëheqësit iranianë thërresin besimtarët të bëjnë protesta kundër botes perëndimore e kundër luftërave

në Irak, Afganistan, Palestinë e vende tjera islamike.

Për këtë arsye, Arabia Saudite i bën të ditur botës, se nuk lejon që askush të "shqetësojë qetësinë dhe atmosferën e Haxhit, dhe t'i qesë në rrezik jetën e pelegrinëve apo të krijojë ndarje mes myslimanëve dhe sekteve të tjera përbrenda botës islamike".

(Marrë nga Radio Vatikan)

Benedikti XVI FAO-s: të njohësh vlerën e mbinatyrshme të çdo njeriu, është hapi i parë për zhdukjen e urisë e të mjerimit

Planeti ka ushqim të mjaftueshëm për të gjithë, duhet të bashkojmë forcat për të fituar mbi urinë! Është thirrja e fuqishme e Benediktit XVI, në sesionin e hapjes së Takimit botëror të rangut të lartë për Sigurinë Ushqimore i FAO-s në Romë. Ati i Shenjtë nënvizoi se për ta mundur urinë, duhet njohur vlera e mbinatyrshme e njeriut.

Fjalimi historik i Papës u mbajt në praninë e shumë personaliteteve të larta shtetërore, ardhur nga mbarë bota. Ndërmjet tyre, sekretari i përgjithshëm i OKB, Ban Ki-Mun dhe drejtori i përgjithshëm i FAO-s, Zhak Diuf, që i drejtoi një përshëndetje të posaçme Benediktit XVI:

"Uria është çaku më mizor e më konkret i varfërisë. Nuk është e mundur më të pranohen skamja e shpërdorimi, kur drama e urisë merr përmasa gjithnjë më të mëdha".

Papa ripohoi impenjimin e Kishës katolike për t'i mbështetur me fjalë, me vepra e me solidaritet, të gjitha përpjekjet, që kanë për qëllim ta zhdukun urinë: *"Kisha – siguroi Ati i Shenjtë – nuk pretendon të ndërhyjë në rrugëzgjdhjet politike; ajo, plot respekt për njohuritë dhe rezultatet e shkencave, si dhe për rrugët e përcaktuara nga arsyeja, kur ndriçohen nga vlerat e vërteta njerëzore, bashkon forcat me të gjithë njerëzit, që përpiqen për zbulimin e urisë".* Kemi nevojë për solidaritet të frymëzuar nga dashuria – tha Papa – gjë që duhet bërë pa vonesa e pa kom-

promise. Ky solidaritet – vërejt në vijim Benedikti XVI – i beson teknikës, ligjeve e institucioneve, por pa e përjashtuar përmasën fetare, me forcën e saj të pushtetshme shpirtërore e me kujdesin për zhvillimin e gjithanshëm të njeriut:

"Ta njohësh vlerën e mbinatyrshme të çdo burri e të çdo gruaje – vërejt Benedikti XVI – mbetet hapi i parë për të favorizuar kthesën e zemrës, që mund të mbështesë impenjimin për çrrënjosjen e mjerimit, të urisë e të varfërisë, në të gjitha format e saj".

"Në rrethana të tilla – reflektoi Ati i Shenjtë – është e nevojshme të kundërshtohet edhe përdorimi i disa formave të subvencionit, që e trondisin rëndë sektorin bujqësor; këmbëngulja e gabuar për përdorimin e modeleve ushqimore, që vënë në plan të parë konsumin, pa llogaritur perspektivat me rreze më të gjërë e, posaçërisht, egoizmi, që i bap spekulimit rrugët për të byrë deri në tregjet e drithërave; prej këndej, ushqimi konsiderohet si masë e të gjitha mallrave të tjera".

Në vijim Papa foli për bashkëpunimin ndërkombëtar që, saktësoi, duhet të përkohet me parimin e ndihmës. E kjo, sepse zhvillimi i gjithanshëm njerëzor ka nevojë për rrugëzgjdhje plot përgjegjësi nga ana e të gjithëve e kërkon një solidaritet të tillë, që nuk i konsideron ndihmën ose emergjencën si mjete për t'i vënë pasuritë në dispozicion të grupeve elitare, të cilat përfitojnë në të parat prej tyre. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta ndjejë

përgjegjësinë e saj të përbashkët, kur është fjala për zhvillimin e vendeve më të varfëra:

"Brenda këtij konteksti – poboï Papa – përfshihet edhe e drejta e secilit vend për të përcaktuar modelin e vet ekonomik, duke parashikuar mënyrat, të cilat garantojnë lirinë e rrugëve që duhen zgjedhur e të qëllimeve që duhen arritur. Në një perspektivë të tillë, bashkëpunimi duhet të bëhet mjet i frytshëm, i çliruar nga pengesat e interesat, që mund të thithin një pjesë të mirë të burimeve të caktuara për zhvillimin. Ka rëndësi të nënvizohet se rruga solidare për zhvillimin e vendeve të varfra, mund të bëhet rrugë që çon edhe në zgjidhjen e krizës globale, në vijim e sipër".

Në situatën e sotme – vijoi Papa – vërejmë ende një nivel zhvillimi të pabarabartë në gjirin e kombeve e ndërmjet tyre. E kjo e thekson edhe më shumë kontrastin ndërmjet pasurisë e varfërisë. Nga ana tjetër – vërejt Benedikti XVI – ekziston rreziku që uria të shikohet si fenomen strukturor, si pjesë përbërëse e realiteteve shoqëro-politike të vendeve të ligështa, si objekt pakënaqësie ose indiference:

"Nuk është kështu, e nuk duhet të jetë kështu! – tha Papa. – Për ta luftuar e për ta mundur urinë, është e rëndësishme t'i ripërcaktojmë konceptet e parimet, që janë zbatuar deri tani në marrëdhëniet ndërkombëtare".

Ç'gjë mund ta orientojë vëmendjen dhe sjelljen e shteteve ndaj nevojave që kanë të varfërit? – pyeti Papa. Përgjigjia – tha Ati



i Shenjtë – nuk duhet kërkuar në natyrën operative të bashkëpunimit, por në parimet, që duhet ta frymëzojnë atë: vetëm në se pranohet që të gjithë i përkasin familjes universale njerëzore, mund t'i kërkohej çdo populli e, prej këndej, edhe çdo vendi, të jetë solidar, duke favorizuar ndarjen e përbashkët të pasurive, bazuar mbi dashurinë.

Në vijim Papa pohoi me forcë: *"Është e vërtetë se solidariteti i frymëzuar nga dashuria i kalon çaqet e drejtësisë, por nuk është kurrë pa drejtësi, sepse: 'Nuk mund t'i jap tjetrit gjënë time, nëse në radhë të parë nuk i jap atë, që i takon sipas drejtësisë'".*

"Nëse synohet vërtetë të zbulohet uria – poboï Papa – veprimtaria ndërkombëtare është e thirrur jo vetëm të favorizojë zhvillimin ekonomik të drejtësuar e të qëndrueshëm, si dhe stabilitetin politik, por edhe të kërkojë parametra të reja – së pari etike, e pastaj juridike dhe ekonomike – që janë në gjendje të frymëzojnë veprimtari bashkëpunimi për krijimin e lidhjeve të barabarta ndërmjet vendeve në shkallë të ndryshme zhvillimi".

Papa ngriti zërin që tregu

ndërkombëtar të jetë i hapur për prodhimet e zonave më të varfra, të cilat kështu mund të sigurojnë më shumë të ardhura, garanci e zhvillimit e prelude të sigurisë ushqimore.

Krahas ushqimit, Papa kujtoi edhe të drejtën themelore për furnizimin me ujë, pa dallime e diskriminime, si dhe lidhjen e ngushtë ndërmjet zhvillimit e mbrojtjes së ambientit, sfida kjo e fundit, për sigurimin e një zhvillimi më të harmonishëm, që respekton planet krijuese të Zotit e kështu është në gjendje ta shpëtojë Planetin nga shumë rreziqe, ndërmjet të cilave theksoi fenomenin e ndryshimeve klimaterike:

"Por normat, ligjshmëritë, planet e zhvillimit e investimet nuk mjaftojnë – poboï – sepse duhet ndryshuar stili personal e komunitar i jetesës, mënyra e konsumit dhe e plotësimit të nevojave të ndryshme. Mbi të gjitha, është e nevojshme të kujtojmë detyrën morale të dallimit të së mirës nga e keqja në veprimet njerëzore, për të zbuluar kështu, lidhjet që bashkojnë njeriun me Hyjin".

(Përgatiti: Don Pal Tunaj)



Filipi Apostull

■ PËRGATITI:
Don Marjan MARKU

Në numrin e apostujve Filipi përherë qëndron në vendin e pestë. (kështu te Mt 10,3; Mk 3,18; Lk 6,14; Apg 1,13), në të vërtetë, në rendin e të parëve. Edhe pse Filipi kishte një prejardhje judenjsh, emri i tij, sikurse edhe i Andreut, ishte emër grek dhe kjo tregon një shenjë

të vogël në kuptimin kulturor të asaj kohe. Lajmet, të cilat na tregojnë mbi jetën e tij, na i sjell ungjilli i Gjonit. Ai vjen nga i njëjti vend prej nga vijnë edhe Pjetri dhe Andreu, pra nga Betsaida (krah. Gjn 1,44), një qytet i vogël, i cili i takonte njeri prej fëmijëve të Herodit të madh dhe i cili e kishte po ashtu emrin Filip (krah. Lk 3,1). Ungjilli i katërt na lajmëron se Filipi, pasi që kishte marrë thirrjen prej Jezusit për të

shkuar pas tij, ai e kishte takuar Natanaelin dhe i kishte thënë: "E gjetëm atë, për të cilin shkroi Moisiu në Ligj dhe Profetët: Jezusin, birin e Jozefit, nga Nazareti" (Gjn 1,45).

Në këtë fjalë Natanaeli kishte një përgjigje skeptike: »Nga Nazareti? A mund të dalë gjë e mirë?«. Në këto fjalë Filipi nuk u dorëzua por i tha: »Eja e shih!« (Gjn 1,46). Në këtë përgjigje të shkurtër dhe të qartë, Filipi tregon vendosmërinë e tij të qartë për të dëshmuar Krishtin duke mos e pranuar fjalën e Hyjit sikurse një teori, por duke u munduar që atë ta argumentojë duke biseduar me të dhe duke tentuar për ta bindur dhe i propozon që ai personalisht ta shohë dhe të dëshmojë kush është Krishti. Të njëjtat fjalë Jezusi i përdor kur dy nxënësit e Gjonit iu afruan dhe e pyetën ku banon:

»Ejani e shihni!« (krah. Gjn 1,38–39). Ne duhet ta pranojmë se dy fjalët që i përdor Filipi për ta bindur Natanaelin, vëjnë edhe për gjithë ne. Ai po ashtu edhe ne na thotë, sikurse i tha edhe Natanaelit:


»Eja e shih!«. Ky apostull na obligon që të vijmë më afër për ta njohur për së afërmi Jezusin. Në veprë duhet pasur miqësi për ta njohur të vërtetën e të tjerëve, afërsinë për të jetuar me të tjerët. Në realitet, nuk duhet harruar se Jezusi sipas fjalëve të Markut, i kishte zgjedhur të dymbëdhjetit me mendim "që t'i ketë pranë vetes" (Mk 3,14), për ta ndarë jetën e tyre me të dhe nga ai të mësojnë dhe ta përfutur realitetin e tij. Vetëm kështu, duke marrë pjesë në jetën e tij, ata mund ta njihnin dhe pastaj ta shpallnin. Pastaj lexojmë në letrën e shën Palit drejtuar Efezianëve, se ai ka ardhur »për të mësuar mbi Krishtin« (krah. Eph 4,20), pra jo në rend të parë për ta njohur mësimin e tij, apo për t'i dëgjuar fjalët e tij, por shumë më tepër për ta njohur atë personalisht, Hyjnin e tij, fshehtësitë e tij dhe bukurinë e tij. Ai nuk është vetëm një më-

sues, por ai është më tepër një mik, ai është një vëlla i tyre. Si mund ta njohim atë përnjëmend, nëse qëndrojmë larg tij? Marredhënit e afërta, lidhshmëria dhe besimi na ndihmojnë që ta zbulojmë identitetin e vërtetë të Jezu Krishtit. Dhe për këtë ne përkujtojmë Filipin apostull. Kështu ai na thërret për "të ardhur" dhe për "ta parë" dhe kjo domethënë ditë për ditë të jemi në lidhshmëri të dëgjimit me Jezusin dhe të përgjigjimit në thirrjen e tij, duke hyrë me të në një jetë të përbashkët. Në ndodhinë e shumimit të bukëve, Filipi iu drejtua Jezu Krishtit me një pyetje befasese: Ku të blejmë bukë që të hanë gjithë këta njerëz (krah. Joh 6,5). Dhe këtu Filipi foli me një realizëm të madh: »As dyqind denarë bukë..., nuk do të dilnin mjaft për t'i dhënë secilit nga një grimë« (Gjn 6,7). Ungjilli vazhdon, foli kështu për ta sprovuar, sepse ai vetë e dinte se çka kishte në mend të bente (krah. Gjn 6, 6). Se çka ka ndodhur më vonë e dimë të gjithë. Ne e dimë, se Jezusi mori bukë, u falënderua dhe ua dha atyre që ishin ulur. Kështu ndodhi shumimi i bukëve. Interesant është, se Jezusi iu drejtua Filipit, për të fituar një përgjigje se si kishte për ta zgjedhur problemin: një shenjë e hapur për ta pasur Filipin një ndër të afërmit e tij. Në një vend tjetër, për ndodhitë e mëvonshme një pikë shumë e rëndësishme, pak para vuajtjes së Jezusit, erdhën disa grekë të cilët kishin ardhur për Pashkë në Jeruzsalem, "ata iu afruan Filipit, që ishte prej Betsaidës së Galileës dhe iu lutën: »Zotëri, dëshirojmë ta shohim Jezusin.« Filipi, shkoi dhe i tha Andreut; Andreu e Filipi shkuan e i treguan Jezusit (Gjn 12,20–22). Përsëri kemi një lajm për shikimin e tij të posaçëm brenda kolegjit të apostujve. Para së gjithash, ai prezantohet si ndërmjetësues në mes grekëve që pyetnin dhe Jezusit. Sipas gjitha gjasave ka folur greqisht dhe në këtë rast ka pasur edhe rrolin e përkthyesit, – dhe se bashku me Andrun, i cili po ashtu fliste greqisht dhe kishte emrin grek, është ai i cili u drejtohet te huajve, në këtë rast grekëve. Këtu na mëson edhe neve që të jemi të gatshëm që në një anë t'i pranojmë pyetjet dhe lutjet, pa arsye prej nga dhe kush vijnë që t'i pranojmë dhe në anën tjetër t'i drejtojmë tek Hyji, i cili i vetmi mund t'i plotësojë tërësisht. Është me rëndësi që të kuptojmë se ne nuk jemi adresa e lutjeve, por Hyji: tek ai duhet që të sjellim gjithkënd, i cili gjendet

në nevojë; secili prej nesh duhet të jetë një rrugë, e cila drejton kah ai!

Pastaj kemi edhe një rast të posaçëm ku e shohim Filipin si në prapashetë. Gjatë darkës së fundit, pasi që Jezusi kishte thënë se kush e njeh atë e njeh edhe atin (krah. Gjn 14,7), dhe në këto fjalë, Filipi i tha: »Zotëri, na e dëfto Atin e na mjafton« (Gjn 14,8). Jezusi u përgjigj me plotë dashuri: »Kaq shumë kohë jam me ju e nuk më njohe ende, Filip? Kush më ka parë mua, ka parë edhe Atin. Si mund të thuhet: Na e dëfto Atin? Po a nuk e beson se unë jam në Atin e Ati është në mua? ... Më besoni mua: Unë jam në Atin dhe Ati është në mua« (Gjn 14,9–11). Këto fjalë janë fjalë shumë të rëndësishme në Ungjillin e Gjonit. Ato kanë një shpallje të vërtetë. Në fund të Prologut të Ungjillit të tij, Gjonit thotë: »Hyjin kurrë askush nuk e pa: Biri i vetëm, që është Hyji, një natyrë me Atin, Ai bëri të njihet« (Gjn 1,18). Kjo dëshmi, e cila rrjedh prej Ungjillit, është pranuar dhe është forcur prej vetë Jezu Krishtit, por vetëm me një nuancë tjetër. Sipas prologut të Gjonit, duke folur për fjalën e tij dhe mësimin e tij, Jezusi tërheq përgjigjen e Filipit dhe tregon se fuqia e tij është aq e qartë se nuk kuptohet nga ajo çka ai thotë, por nga ajo se ai është i thjeshtë. Për ta kuptuar më mirë; Hyji ka marrë natyrën tonë njerëzore, natyrën e Jezusit për ta njohur në realitet fytyrën e Hyjit. Në fytyrën e tij shohim realitetin e fytyrës hyjnore, kush është Hyji dhe si është Hyji!

Ungjilli nuk na tregon se a i ka kuptuar Filipi tërësisht fjalët e Hyjit. E vërteta është një, se ai tërë jetën e vet ia ka dhuruar atij. Sipas disa lajmeve Filipi kishte predikuar Ungjillin në Greqi dhe në Frigi dhe atje në Hierapolis, kishte vdekur përmes kryqëzimit apo gjuajtjes me gurë. Në dëshirojmë që këtë përsiatje ta përfundojmë duke vënë një cak të jetës sonë të cilin dëshirojmë ta realizojmë në jetën tonë: që ta takojmë Jezusin ashtu siç e ka takuar edhe Filipi, duke tentuar që ta shohim në të Atin qielor. Nëse nuk bëjmë një tentim të tillë, atëherë në pasqyrë do e shohim vetëm vetën dhe përherë do të jemi të vetmuar. Filipi na mëson që të jemi të përdorur prej Jezusit, që të jemi tek ai dhe që t'i ftojme edhe të tjerët që të marrin pjesë në këtë bashkësi të pandashme, për ta parë atë, për ta gjetur atë dhe në të për ta gjetur jetën e vërtetë.



Viti meshtarak

Veprat kryesore të famullitarit të Arsit

1. Iniciativa të ndryshme apostolike të orientuara drejt thelbësorës

Shën Gjon Maria Vianney ishte i drejtuar drejt mësimit të fesë, të pastrimit të ndërgjegjes (*këto dy drejtime kryqëzoheshin në Eukaristi*). A nuk është nevojshme t'i rishikojmë tri poetet e shërbimit pastoral të meshtarit.

Nëse qëllimi kryesor është t'i bashkojnë popullin e Hyjit rreth misterit eukaristik, nëpër mjet katehezës e pendesës, por edhe kontakte tjera apostolike, sipas rrethanave janë të nevojshme: ndo një herë një prani e thjeshtë, ndoshta për shumë vjet më dëshmi të qetë në ambiente jo të krishtera, dhe afrimi i personave dhe i familjarëve dhe i preokupimeve të tyre. Disa herë ky mund të jetë hapi i parë i ungjillëzimit që mundohet të zgjojë dëshirën e fesë në ata që nuk besojnë; mund të jetë edhe dëshmia e bamirësisë dhe e dashurisë së jetuar nga besimtarët e krishterë, kështu që në këtë mënyrë e bëjnë më të besueshme fenë duke e vënë në praktikë. Në këtë mënyrë një grumbull aktivitetesh të veprave apostolike e përgatisin dhe e vazhdojnë formimin e krishterë. Edhe Shën Gjon Maria Vianney u mundua me gjithë fuqitë e tij të marrë disa iniciativa të përshtatshme për kohën e tij e për besimtarët e tij. Megjithatë, krejt aktivitetet e tij meshtarake qëndronin në Eukaristi, Katecheza, dhe sidomos në sakramentin e pajtimit (Rrëfimit).

2. Sakramenti i rrëfimit (pajtimit)

Është padyshim përkushtimi total i sakramentit të pendesës ai që e ka bërë të famshëm Shën Gjon Maria Vianney-in. Është mirë dhe e nevojshme që një shembull i tillë edhe sot të na shtyjë në të kontribuojmë për sa i përket sakramentit të pajtimit dhe rrëndësinë e ngritur nga sinodi i ipeshkvijve të vitit 1983 që drejtësisht e kanë vënë në dritë.

Pa kthim, pa pendesë dhe pa kërkuar falje prej Zotit, që meshtarët duhet t'ua ofrojnë popullit të palodhshëm të inkurajojnë për të pranuar dëshirën e rirreskimit që është e adresuar të qëndrojë sipërfaqësore dhe jo reale.

Famullitari i Arsit brengosej para së gjithash në formimin e besimtarëve në dëshirën e pendimit. Shpeshherë theksonte bukurinë e faljes hyjnore. A nuk ishte e krejt

jeta e tij një përkushtim i plotë për kthimin e mëkatarëve? E mu për këtë në rrëfytore manifestohet e krejt mëshira hyjnore. Ai nuk e përjashtonte askënd e aq më pak ata që vinin prej së largu dhe të cilëve ia kushtonte shpeshherë 10 orë e nga një herë edhe 15 orë në ditë. Për të pa tjetër do të ketë qenë një ndër veprat asketike më të mëdha, po thuajse një martirizim: fizikisht para së gjithash, në të ftohët, në të nxehtë, në mungesë të ajrit të mjaftueshëm; edhe moralisht, sepse vuante edhe ai vetë prej mëkateve të rrëfimit e aq më tepër për mungesë të pendimit: "qaj për atë që ju nuk qani". Pranë këtyre indiferencave që ekzistonin, dhe që ai i pranonte dhe mendohej të zgjojë me dashurinë e Krishtit, Zoti i jepte edhe dhuratën t'i pajtojë edhe mëkatarët më të mëdhenj të penduar dhe t'i drejtojë shpirtat drejt përsosmërisë, normalisht ata shpirta që e kishin dëshirën e gjallë. Ishte pikërisht këtu që Jezu Krishti e ftonte të marrë pjesë në shëlbim.

Në sot e kemi rizbuluar, më mirë se sa në shekullin e kaluar, aspektin bashkiak të pendesës, të përgatitjes në falje, e të veprimtimit të hirit pas faljes. Por falja sakramentale kërkon gjithnjë një takim personal me Krishtin e kryqëzuar nëpër mjet ndërmjetësimi të shërbëtorëve të tij. Shpesh herë, mjerisht, pendestarët nuk afrohen rreth rrëfytoreve me vullnet, sikur në kohët e famullitarit të Arsit.

Tani për faktin që një numër i konsiderueshëm, për motive të ndryshme, duket të mos praktikojë sakramentin e rrëfimit, është shenjë e urgjencës së zhvillimit të një pastoralit të sakramentit të pendimit, duke u mundësuar të krishterëve që të zbulojnë nevojën e një marrëdhënie të sinqertë me Zotin, ndjeshmërinë e mëkatit, për të cilin mbyllemi Tjetrit dhe tjerëve, nevojën për t'u kthyer dhe për të pranuar, nëpër mjet Kishës, faljen si dhuratë e Zotit, e në fund edhe kushtet për të kremtuar mirë sakramentet, duke i tejkaluar edhe paragjykimet në atë drejtim, dhe frikën e rrëfshme. Një situatë e tillë kërkon në të njëjtën kohë edhe që në të jemi të disponueshem dhe të gatshëm për këtë shërbesë të faljes, të gatshëm gjithashtu edhe për t'i kushtuar kohën dhe kujdesin e nevojshëm, e madje t'i jepet prioritet në krahasim me aktivitetet

tjera. Kështu që besimtarët do të kuptojnë vlerën, që nën shembullin e famullitarit të Arsit ne i japim.

Sigurisht, sikur shkruaja në thirrjen post-sinodale mbi pendesën, shërbesa e pajtimit mbetet pa dyshim, më e vështira dhe më delikate, më i rëndi dhe më kërkuesi, e sidomos kur meshtarët janë në numër të vogël. Ky sakrament kërkon, edhe për meshtarin shumë kualitete njerëzore e sidomos një jetë shpirtërore shumë intensive dhe të sinqertë; është e nevojshme që vetë meshtari ta praktikojë këtë sakrament.

Jeni gjithmonë të bindur, të dashur meshtarë: kjo shërbesë e mëshirës është shërbesa më e mirë dhe më ngushtëlluesja. Ju mundëson të ndriçoni vetëdijen, të falni, dhe që t'i jepni një rrëndësi të re në emër të Jezusit Zot. Dhe që të jeni për ta mjek dhe këshilltar shpirtëror; ky sakrament mbetet pa dyshim manifestim i pazëvendësueshëm i verifikimit të shërbesës meshtarake.

3. Eukaristia: kushtimi i meshës, kungimi dhe adhurimi

Dy sakramentet, rrëfimi dhe eukaristia janë ngushtë të lidhur njëra me tjetrën. Pa një kthim të qëndrueshëm dhe të ripërtëritë e pa pranimin e hirit sakramental të pajtimit, pjesëmarrja në sakramentin e eukaristisë nuk do të kishte efikasitetin e saj shpëtimor. Sikur Krishti që e filloi veprimtarinë e tij publike me "Kthehuni e besoni ungjillit", ashtu edhe famullitari i Arsit i iniciante gjithnjë ditët e tija me shërbesën e pajtimit. Dhe ai që i lumtur t'i drejtonte pendestarët e vet drejt eukaristisë.

Eukaristia ishte qendra e jetës së tij shpirtërore dhe të pastoralit të tij. Thoshte: "Krejt veprat e mira të realizuara nuk barazohen me flinë e meshës, sepse ato janë vepra njerëzore ndërsa mesha është veprë hyjnore". Mu aty është realizuar filja e Kalvarit për shëlbimin botës. Normalisht meshtari duhet të bashkojë jetën e përditshme të vetvetes me sakrificën e meshës: "një prift bën mirë që të ofrojë vetveten Zotit në flirjim për çdo mëngjes". "Kungimi i shenjtë dhe filja e shenjtë e meshës janë dy aktet me efikasitet për të arritur kthimin e zemrave".

Mesha ishte për Shën Gjon Maria Vianney gëzimi më i madh dhe shpërblimi i meshtarit të tij. Ai i kushtonte shumë rrëndësi



dhe angazhim përgatitjes përpara meshë, edhe pse pendestarët e shumë nuk e lenin, për 15 minuta në heshtje përgatitje. Kremtonte i përqendruar, duke shprehur qartazi adhurimin e tij në momentet si të shugurimit ashtu edhe të kungimit. Me realizëm theksonte: "shkaku i relaksimit të meshtarëve është që nuk i vëjnë rrëndësi meshës".

Famullitarin e Arsit e prekte sidomos fakti i pranisë reale të Krishtit në eukaristi. Qëndronte vazhdimisht përballë tabërnakullit, dhe aty kalonte orët e tëra adhurimi, para agimit ose në mbrëmje; dhe drejt tij shpesh herë drejtohej në homelitë e tij duke thënë: "Ai është atje!". Dhe akoma për këtë arsye që ai, kështu i varfër në konakun e vet, nuk hezizonte të shpenzonte shumë para për të zbuluar kishën e tij. Shumë me vlerë ishte fakti se besimtarët e tij shumë shpejt morën traditën e mirë që të luten para të shejtnueshmit sakrament, duke zbuluar nëpërmjet famullitarit të tyre madhësinë e misterit të fesë.

Në këtë drejtim, në lidhje me këtë dëshmi, të ndalemë e të mendojmë se çka thotë Koncili i dytë Vatikanas mbi meshtarët: "pikërisht në kultin eukaristik ushtrohet në veçanti shërbesa e shenjtë e meshtarit". Gjithashtu edhe sinodi i fundit (dhjetor 1985) kujtonte: "liturgia duhet të favorizojë sensin e hyjnore. Duhet të tregojë nderimin, adhurimin, dhe lavdinë e Hyjit...Eukaristia është burimi dhe kulmi i krejt jetës së krishterë".

Të dashur vëllezër meshtarë, shembulli i famullitarit të Arsit na grish në një rrëhim serioz të ndërgjegjes sonë: çfarë vendi i japim gjatë ditës meshës? A mbetet ajo sikur në ditën e shugurimit

si vepra e parë e meshtarit sonë!-, fillimi veprimeve tona apostolike e të shenjtërit tonë personal? Çfarë kujdesi i kushtojmë në përgatitje të saj? Në kremtimin e saj? Në lutje dhe adhurim para shenjtërit sakrament? Në drejtimin e besimtarëve tanë? Në shndërrimin e kishave tona në shtëpi hyjnore, nëpërmjet të cilave prania hyjnore tërheqë bashkëkohanikët tanë që shpesh e kanë mendimin e një botë pa Zot?

4. Predikimi dhe Kateheza

Famullitari i Arsit insistonte pa masë që mos të lihej pas dore shërbesa e fjalës, absolutisht e nevojshme për të ndihmuar fenë dhe kthimin kah Zoti. Shtonte duke thënë: Zoti ynë, që është e njëjta e vërtetë nuk ka rrëndësi më të vogël se fjala e Korpi i tij. Dihet koha që ai i kushtonte, sidomos në fillim për të përgatitur predikimet e së dielës. Dhe pastaj ai arriti të shprehë më spontanisht, gjithmonë më bindje edhe me të mëdha, më të qarta, duke përdorur edhe figura dhe krahasime të marra nga jeta e përditshme të cilat tërhiqnin pa masë jetën e besimtarëve. Edhe mësimi i fesë për fëmijët përbente një pjesë e rrëndësishme të shërbimit të tij meshtarake, që gjithashtu edhe të rriturit bashkoheshin me vullnet fëmijëve për të shfrytëzuar dëshminë e këtij shenjtë të pa shoq.

E kishte guximin për të shpallur të keqen në 38 forma të ndryshme; pa kurrfarë kompleksesh, sepse kjo shkonte në të mirën dhe në shpëtimin e përditshëm të besimtarëve të tij: "nëse një bari rri i pajalë duke e parë Zotin të braktisur dhe shpirtat në shkatërrim e sipër, mjerë ai! Nëse ai nuk dëshiron të humbasë, nevojitet që, nëse ekziston ndonjë

parregullsi në famullinë e tij, ai të vë nën këmbë respektin njerëzor dhe frikën që të mos të jetë i nënvlerësuar dhe i urryer nga ana e besimtarëve. Kjo përgjegjësi ishte trishtimi i më i madh i tij si famullitar. Por si zakonisht, ai preferonte të vërente anën pozitive të vrititit se sa të keqen e vesit, e nëse ndo njëherë përkujtonte – duke qarë – mëkatin o rizikun për shpëtim, insiston vazhdimisht mbi butësinë e Zotit të keqpërdorur dhe mbi lumturinë e që jemi të dashur prej Zotit, të bashkuar me Zotin dhe të jetojmë në praninë e tij për të.

Të dashur vëllezër meshtar, ju jeni të bindur mbi rëndësinë e shpalljes së ungjillit, që Koncili i Vatikanit e ka vendosur në vendin e parë të funksioneve të meshtarit. Ju përpiqeni që nëpërmes katëhezave, predikimit, e në format e tjera të mundshme edhe në mjetet pamoro-dëgjimore, që të arrini në zemrat e bashkohasve tuaj, me pritjet dhe dyshimet e tyre, për të ngjallë dhe ushqyer fenë. Sikur famullitari i Arsit e sipas thirrjes së Koncilit, përkushtojuni mësimi të falës hyjnore e cila vazhdimisht i fton të gjithë njerëzit në kthim dhe në shenjtëri.

IDENTITETI I MESHTARIT

5. Shërbesa specifike e meshtarit

Shën Gjon Maria Vianney u ofron një përgjigje bindëse shumë diskutimeve mbi identitetin e meshtarit, që janë manifestuar për ngjatë njëzet viteve të fundit. Tani, megjithatë është duke ardhur deri tek pozicioni më i matur.

Meshtari gjithmonë, e në mënyrë të pandryshueshme, e gjen burimin e identitetit të vet në Krishtin meshtar. Nuk është bota për të fiksuar statutin e tij, sipas nevojave dhe konceptimeve të rolit shoqëror. Meshtari është i shënuar prej vullës se meshtarisë së Krishtit për të marrë pjesë në funksionin e vetëm si ndërmjetësues dhe shëlbues.

Për shkak të kësaj lidhjeje fundamentale, i hapet meshtarit fusha e pakufi e shërbimit të shpirttrave, për shpëtimin e tyre në Krishtin dhe në Kishën. Një shërbim që duhet plotësisht të jetë i frymëzuar prej dashurisë për shpirttr, në përngjasim të Krishtit që e dhuron jetën e vet për të gjithë. Hyji dëshiron që të gjithë të shpëtohen, që askush, edhe prej atyre më të vegjëlle mos të humbet: "meshtari duhet gjithmonë të jetë i gatshëm t'i përgjigjet nevojave të shpirttrave", thonjtë famullitari i Arsit. "Ai nuk është për vete, por për ju".

Meshtari është për besimtarët: ai i gjallëron dhe i drejton në ushtrimin e meshtarisë së përbashkët të të pagëzuarve – të vënë në dukje aq mirë prej Koncilit të Dytë Vatikanas – e që konsiston që jeta të bëhet një kusht shpirtëror, që të jemi dëshmitarë

të shpirtit të krishterë në familjet tona, që të marrim përgjegjësi në angazhimet kohore, e që të jemi pjesëmarrës në ungjillëzimin e vëllezërve. Megjithatë, shërbimi i meshtarit është i një rendi tjetër. Ai është i shuguruar për të vepruar në emër të Krishtit – kryet, për t'u mundësuar njerëzve të hyjnë në një jetë të re të përruar prej Krishtit, për t'i bërë – pjesëtarë të mistereve të tij- Fjala, Falja, Buka e jetës – për t'i bashkuar në trupin e tij, për t'i ndihmuar që të formohen nga brenda, dhe në fund që të jetojnë dhe veprojnë sipas planit shpëtimprurës të Hyjit. Në sintezë identiteti i yni i meshtarëve manifestohet në shpjegimin e dashurisë "krijuese" për shpirttr të komunikuar prej Jezu Krishtit. Të gjitha përpjekjet e laicizimit të meshtarit janë të dëmshme për Kishën. Kjo nuk do të thotë asesi që meshtari duhet të jetë larg brengave njerëzore të besimtarëve: përkundrazi duhet të jetë shumë afër, sikur Shën Gjon Maria Vianney, por si meshtar, gjithmonë në perspektivë e shpëtimin të tyre dhe në rritjen mbretërisë hyjnore. Ai është dëshmitari dhe dhuruesi i një jetë të ndryshme prej asaj njerëzore. Është më se themelore edhe e nevojshme për Kishën të ruajë me xhelozë identitetin e vërtetë të meshtarit me dimensionin e saj vertikal. Jeta dhe personaliteti i famullitarit të Arsit janë një ilustrim dhe dëshmi e ndritshme.

6. Konfigurimi i tij intim me Krishtin dhe solidariteti i tij me mëkatarët

Shën Gjon Maria Vianney nuk kënaqej vetëm me plotësimin apo kremtimin e riteve dhe vepërave të shërbimit të tij. Ishte pikërisht me zemër dhe me jetën e tij që mendohej t'i përngjante Krishtit. Lutja ishte shpirti i jetës së tij: lutje në heshtje, kontemplative, para së gjithash në kishën e tij, pranë tabernakullit. Nëpërmjet Krishtit, shpirti i tij hapej drejt tre Vejeve të Trinisë Shenjtë, të cilëve ai në testament do t'u dorëzojë "shpirtin e tij të varfër". Mbante gjithnjë një bashkim të qëndrueshëm me Zotin, në mesin e jetës së vet gjithmonë të zënë. Por asesi nuk lentë kurrë anash as lutjen e breviarit e as rruazën shenjtë. Në mënyrë spontanë shpeshherë i drejtohej Zojës së bekuar.

Varfëria e tij ishte e jashtëzakonshme. Hiqte tekstualisht rrobat e veta për të varfrit. E u ikte nderimeve. Pastërtia shpirtërore ndriçonte në shikimin e tij. E njihte çminin e pastërtisë për të gjetur burimin e dashurisë që është Zoti. Dëgjesa ndaj Krishtit përkthehej në dëgjuesin ndaj Kishës, e në mënyrë të veçantë ndaj ipeshkvit. Mishërohej në pranimin e detyrës së famullitarit që shpesh herë e frikësonte.

Por ungjilli insiston vazhdimisht në mohimin e vetvetes, në pranimin e kryqit. Shumë kryqje ju paraqiten famullitarit të Arsit përngjatë shërbesës meshtarake: kërcënime të njerëzve, moskup-


timet e një vikari apo të vëllezërve, kundërshtime, e një luftë misterioze kundër forcave të ferrit, e deri të një tundim i dëshpërimit të shpirtit në mesin e natës.

Megjithatë, ai nuk kënaqej t'i pranonte këto prova pa ankime: shkonte drejt mohimit, bënte vazhdimisht pendesë, dhe forma tjera "për ta bërë trupin e tij shërbim", sikur thotë ndër të tjera edhe Shën Pali. Por ajo që duhet verë në dukje prej kësaj pendese, gjë që shekulli dhe mentaliteti ynë është larguar, janë arsyet: dashuria e Zotit dhe kthimi i mëkatarëve. Kështu ai e interpretonte një vëllë të vetin të dëshpëruar: "A keni lutur?... a keni kërkuar..., a keni bërë pendesë..., a keni vigjiluar?...". Dhe arrihet këtu në fjalët e Jezu Krishtit drejtuar apostujve: "kjo racë e dajave largohet vetëm me uratë dhe pendesë".

Definitivisht, Gjon Maria Vianney, shenjtërohej si akt për shenjtërimin e tjerëve. Sigurisht, kthimi mbetet sekret i zemrës, të lirë në vendimarrje, e fshehtësia e Hirit të Hyjit. Me shërbesën e vet, meshtari s'bën tjetër për veç se të ndriçojë personat, t'i drejtojë në rrefyestore, e të dhurojë atyre sakramentet. Këto sakramente, janë patjetër vepra e Krishtit, efikasiteti i të cilave nuk zvogëlohet nga mospërkryerja e meshtarit. Por rezultati varët edhe nga gjendja e atij që i pranon, e këto janë të favorizuara gradualisht prej shenjtërisë personale të meshtarit, të dëshmisë së tij të aprovuar, e nga shkëmbimi misterioz i meritave në bashkimin e shenjtë. Shën Pali thotë: "Plotësoji në trupin tim ato që mungojnë në vuajtjet e Krishtit, në dobi të trupit të tij, që është kisha". Shën Gjon Maria Vianney dëshironte të nxirrte prej Hyjit hirit e kthimi, jo vetëm me lutje dhe uratë, por me flimin e krejt jetës së tij. Dëshironte ta duan Hyjin për ata që nuk e donin, e derisa e bënte edhe pendesën e atyre që nuk e kryenin atë. Ishte vërtet bari solidar me popullin mëkatar.

Të dashur vëllezër meshtarë, mos t'i trembemi kësaj përfshirje personale, të shënuar nga flijimi dhe të frymëzuar nga dashuria – që Zoti na kërkon për të ushtruar mirë shërbesën tonë meshtarake. Ju kujtohet reflektimi i fundit sinodale: "duket që në vështirësitë aktuale Hyji dëshiron më thellësisht të na mësojë vlerën, rëndësinë dhe rolin qëndror të Kryqit të Krishtit". Në meshtarin, Krishti ri-jeton pasionin e tij për shpirttr. Të falënderojmë Hyjin, që na mundëson kështu të marrim pjesë në shëlbim në zemrën tonë dhe në mishin tonë!

Për të gjitha këto motive Shën Gjon Maria Vianney nuk ndalet së ekzistuar dëshmitar, gjithmonë i gjallë, gjithnjë aktual, i të së vërtetës mbi thirrjen në shërbimin meshtarak. Le ta kujtojmë tonin bindës në të cilin ai fliste për madhësinë e meshtarisë dhe të nevojës së tij absolute. Meshtarët, ata që përgatitin në meshtari e ata që e jetojnë meshtarinë kanë



“Shën Gjon Maria Vianney - Shembull për të gjithë meshtarët”

shumë nevojë për të fiksuar shikimin e tyre mbi shembullin e tij dhe atë ta ndjekin me vrull. Dhe vetë besimtarët do të kuptojnë më mirë, duke ju falënderuar atij, misterin e meshtarisë së meshtarëve të vet. Jo, figura e famullitarit të Arsit nuk do të perëndojë kurrë!

7. Përfundimi: për të Enjten e madhe

Të dashur vëllezër, uroj që këto reflektime të ringjallin gëzimin tuaj të jeni meshtarë, e dëshirën tuaj të jeni edhe më plotësisht. Dëshmia e famullitarit të Arsit përmban edhe më shumë pasuri për t'u thelluar. Do të kthehemi më gjerësisht, mbi këto tema në rastin e shtegimit që unë personalisht e kam gëzimin ta realizoj në tetorin e ardhshëm në Ars për të nderuar njëqindvjetorin e dytë të lindjes së Shën Gjon Maria Vianney.

Po ju dërgoj këtë meditim të parë, të dashur vëllezër, me rastin e solemnitetit të së Enjtes së Madhe. Në secilën bashkësi dioqezane do të bashkohemi, në atë ditë të lindjes së meshtarisë sonë, për të rinovuar hirin e sakramentit të urdhrat të shenjtë të meshtarisë, dhe për të ripërtituar dashurinë që e karakterizon thirrjen tonë. Të dëgjojmë Krishtin i cili na thotë sikur dikur apostujve: "Nuk ka dashuri me të madhe se kjo: të japësh jetën për miqtë e tu...nuk ju quaj shërbëtor..., ju quajta miq".

Para atij që e manifest-

ton dashurinë në plotësi, ne i ripërtërimë premtimet meshtarake, meshtar dhe ipeshkvi. Të lutemi njëri për tjetrin, secili për vëllanë e vet, e çdo njëri për të gjithë.

T'i kërkojmë Meshtarit të amshuar që përkujtimi i famullitarit të Arsit të na ndihmojë të ringjallë zellin e shërbimit.

Lusim Shpirtin Shenjtë që të fton në shërbimin e Kishës shumë meshtarë të nivelit dhe të shenjtërisë së famullitarit të Arsit: edhe epoka jonë ka nevojë, e jo që nuk është e aftë të sjellë në botë thirrje të tilla.

E ne po ia besojmë meshtarinë tonë Virgjërë Mari, nënës së meshtarëve, të cilës iu lut pa pra Shën Gjon Maria Vianney, me shumë përkushtim dhe me besim të plotë. Ishte edhe ky një motiv për të falënderuar: "Jezu Krishti – thotë – pasi që na dha gjithë atë që pati mundësi, dëshiron të na bëjë edhe trashëgimtar të gjithë asaj që ai a ka si me të çmueshmen, do të thotë Nënë e tij".

Prej anës sime ju vërtetoj krejt dashurinë time e me ipeshkvin tuaj, po ju dërgoj edhe bekimin apostolik.

Prej Vatikanit, 16 mars, e diela e V e kreshmëve të vitit 1986, i treti në papat.

Gjon Pali II

(Shkëputur nga Letra e Shenjtë Atë Papë Gjon Pali II drejtuar meshtarëve)

800-vjetori i lindjes së Shën Françeskut

Karizma e Shën Fr

■ SHKRUAN:
m. Vera PALUCA

Shën Françesku nga Asissi jetoi 45 vite (1181-1226). Është, themelues i rregullave françeskane, që janë të përhapura në tërë botën. Jeto i në kohën e Mesjetës, kur ishte një kohë e errët nga shumë pikëpamje. Zoti e dërgoi shën Françeskun si një dritë. Ai ishte shembull dhe ideal i asaj kohe dhe i ditëve tona. Shën Françesku ishte i thjeshtë, i singertë dhe plot përvujtëri. Njerëzit nuk e kuptonin, në fillim disa edhe e përqeshën duke menduar se i biri i Pjetër Bernardone ishte i marrë, mirëpo shpejt u bindën se gabuan. Sepse veprat e tij ishin vepër e Zotit dhe të shenjtja. Ai prej të tjerëve nuk lupte aq sa bënte vetë. Agjëronte shumë, vishej dobët, nuk posedonte asgjë. Predikonte me vepër, pa fjalime të gjata. Populli

është bindur në veprat e tij. Jeta e tij i mahniti njerëzit duke parë se e jeton Ungjillin e Krishtit. Të rinjtë filluan të shkojnë pas tij. Shën Françesku i pranonte pa pasuri materiale, vetëm pasi u ndanin skamnorëve pasuritë e veta. Jetonin prej punës dhe lëmoshës së popullit. Kur papa e miratoi rregullin e shën Françeskut, numri i rregulltarëve u rrit shpejt. Pas tij shkuan njerëz të thjeshtë, por edhe të mëdhenj. Ju bashkëngjiten edhe shumë vajza bujare edhe shën Klara. Kështu e themeloi rregullin e dytë klariset. Më vonë iu lajmëruan edhe familjarët, kështu u themelua rregulli i tretë i shën Françeskut që quhej rregulli i shekullarëve. Shën Françesku e ka gjetur vendin e vet edhe në krijesat e Zotit, kjo shihet në Këngën e krijesave që e ka shkruar para vdekjes së vet.

Ai çdo krijesë e quan si vëlla dhe motër, duke e lavdëruar Zotin për çdo krijesë edhe motrën



Bashkësia e motrave françeskane

Francëskut të Asizit



Anëtarët e rinj në noviciat në Rregullin e Tretë Francëskan para kishës në Gjakovë

tonë vdekjen trupore. E lavdëron Zotin për diellin, hënën, tokën, yjet, ujin, zjarrin, lulet etj. Ai edhe u shpall si pajtor i ruajtjes së natyrës së bukur. Ne si motra françeskanë të Zojës së Papërlës të provincës së Malit të Zi, u jemi mirënjohës dhe jetë motrave që erdhën nga Sllovenia në Cetinje në vitin 1946. Si Provincë u themelua në vitin 1965. Kongregata jonë është themeluar më 29 shtator 1846 nga themeluesja e jonë është nëna Franciska Antonia Lampel nga Grazi i Austrisë. Këto dhjetë motra sllovene mirë i kuptuan dhe i zbatuan fjalët (Krh. Zan.12,1 Abrahami). Shko nga vendi yt prej shtëpisë së babës tënd në drejtim të një vendi që do të ta tregoj! Shko dhe rregullo shtëpinë time (shën Françesku). Shko, le të ndriçojë drita jote para njerëzve, që të shohin veprat e tua të dashurisë dhe të lëvdojnë Atin qiellor! (Nëna Franciska). Në fillim ishte thirrja e Zotit- SHKO! Ishte e drejtuar Abrahamit, Atë Françeskut, Nënës Franciska. Është e drejtuar edhe dhjetë motrave tona. Thirrja kërkon përgjigje. Përgjigja ndaj thirrjes hyjnore mund të jetë vetëm FEJA, SHPRESA, DASHURIA. Dëshirojmë të jetojmë në mes të njerëzve, duke u përpjekur të jemi pandërprerë të lidhura me Hyjin. Të jemi të

vogla dhe të përvuajtura, që Hyji të na marrë në duart e veta, që Ai të veprojë nëpërmjet nesh. Të gatshme për gjithçka çfarë Kisha kërkon prej nesh. (Fjalët e themelueses n.Franciska). Sot jemi 135 motra të kushtuara, 2 novice, 3 kandidatë. Kandidatura është (kohë e papërcaktuar). Postullati zgjat gjashtë muaj, noviciati dy vite. Kushtet e përkohshme dy plus tri vite. E kur e vejmë nënshkrimin tonë në altar, tek KUSHTET E PËRJETSHME, bëhemi pronë e Hyjit dhe anëtare e Kongregatës sonë. Kandidatët në bashkësinë tonë:

Njohin më mirë mënyrën e të jetuarit,

Shkojnë në shkollë dhe përgatiten për thirrjen e tyre, Marrin pjesë në lutjet e ditës dhe mësojnë të vërtetat e fesë,

Zbulojnë talentet e veta dhe me to i shërbejnë Zotit dhe të afërmit,

Ndajnë me motrat e bashkësisë gëzimet dhe pikëllimet, Piqen në të gjitha sferat jetësore dhe marrin vendimin përfundimtar që t'i kushtohen krejtësisht Zotit,

Të rinj, në qoftë se dëgjoni thirrjen e Zotit mos e refuzoni! Më mirë me trimëri hyni në rrymat e mëdha të shenjtërisë, të cilat i kanë nisur shenjtëreshat

dhe shenjtërit e famshëm në ndjekjen e Krishtit,

Shikoni në ardhmërinë, në të cilën ju dërgon apo fton Shpirti i Jezusit të Ringjallur, që së bashku me ju të bëjë vepra të mrekullueshme në botë. (Papa Gjon Pali II),

Mundohemi të jetojmë shpirtin e shën Françeskut në 35 vende, të cilat janë të shpërndara në shtatë shtete,

Në Kosovë, Mal të Zi, Shqipëri, Kroaci, Slloveni, Gjermani, Amerikë,

Në Kosovë veprojme në Velezh prej vitit 1969,

Në Bishtazhin prej vitit 1975, në Novosellë prej vitit 1975, në Zym prej vitit 1979, në Budisalc prej vitit 1988, në Pjetërshan prej vitit 2003, në gjimnazin Loyola në Prizren prej vitit 2005,

Veprimet tona apostolike: në shërbim të të sëmurëve dhe të moshuarve, në spitale, ambulanca dhe në shtëpitë e të moshuarve,

Si katekiste në famulli me fëmijët dhe të rinjtë që Zoti dhe familjet na kanë besuar,

Udhëheqja e këndimit kishtar edhe e koreve nëpër kopshtet të fëmijëve "të jemi të vogla dhe të përvuajtura" në mes të më të vegjëlve,

Në shkollë dhe konvikte të ndryshme duke u bërë nëna dhe

bashkë udhëtar e vajzave dhe të rejave, duke jetuar në mënyrë me konkrete karizmin fillestar,

Nëpër kuvende dhe institucione si kuzhinierë dhe bashkëpunëtorë,

Në misione në përhapjen e mbretërisë së Krishtit,

"Nëse Hyji nuk na merr në duart e veta të gjithëpushtetshme, ne nuk mund të bëjmë asgjë. (Nëna Franciska).

Kongregatës sonë dhe provincës i takojnë motrat e popujve të ndryshëm, dhe kjo nuk është një pengesë, por begati. Rregulla dhe jeta jonë si françeskanë, është mbajtja e Ungjillit të shenjtë të Zotit tonë Jezu Krishtit, duke jetuar në pastërti, në varfëri dhe dëgjësë. Bukuria e varfërisë është kjo - duke mos pasur shtëpi të mëdha, duke mos qenë të famshme, duke mos pasur pasuri private, por duke pasur një zemër të pasur për rininë

tonë - për fëmijët gëzimin tonë, ardhmërinë tonë! Ndërsa ende jehon kënga e falënderimit për historinë tonë, sytë i drejtojmë kah e ardhmja. O Zot, ku na drejton. Ti e di... Veç të mbesim gjithmonë nën mbrojtjen tënde dhe të pajtores sonë qiellore Virgjërës Mari të Papërlës, Nënës Tënde dhe tonës!

Po i përfundoj këto që i thashë, me lutjen e shën Françeskut të Asizit.

*O Zot, më bëj vegël të paqes sate,
Ku është urrëjtja të vijë dashurinë,
Ku është fyerja ta vë faljen,
Ku është përçarja, ta vë mirëkuptimin,
Ku është mashtrimi, ta them të vërtetën,
Ku është dyshimi ta vë besimin,
Ku është dëshpërimi, të vë shpresën.
Ku është terri, të sjell dritën,
Ku është pikëllimi të sjell gëzimin.*





Intervistë me Age Bojaxhiu-Guttadauro-n, mbesë e Nënës Tereze

E privilegjuar dhe krenare për hallën time - Nënën Tereze

Don Lush Gjergji: Ti e ke njohur Nënën Tereze si të afërmen tënde, si hallën tënde. Përshtypjet tua, sepse ti je e vtemja anëtare e gjallë e familjes së ngushtë të saj? Takimi yt i parë me të, atë çka të tregonte babai yt i madh, Lazri, për familjen Bojaxhiu, për këtë dramë që kishin përjetuar, por që Zoti e ka shpërblyer pa masë?

Si hallë unë e kam njohur personalisht vonë, atëherë kur ajo tashmë ishte e famshme dhe e njohur gati në mbarë botën, kur për të shkruanin shumë gazeta, flisnin shumë qendra radio-televizive, bile përmendej aty-këtu edhe nëpër kisha... Kështu brenda meje rritej dëshira, kureshtja, por edhe nevoja ta njihja për së afërmi, më tërhiqte, fytyra e saj, sepse si më thoshte babai im, Lazri, "gjaku nuk është ujë..." dhe vërtet ashtu është...

Jam takuar me Nënën Tereze për herë të parë personalisht në janar të vitit 1967, sepse papa Montini - Pali VI e kishte ftuar për të hapur një shtëpi në Romë. Përshtypja ime ishte e papërshtueshme dhe e paharrueshme, një gëzim, i cili më kaplonte në tërësinë e qenies time... Gëzimi kishte shumë rasye: sepse babai im dhe Nëna Tereze ishin vërtet të lumtur, shiheshin pas më se 30 vjete... Mendoni pak çka kanë përjetuar këto dy persona, zemra e vëllaut dhe e motrës! Ishte një takim vërtet unik!

Gjatë këtyre viteve as nuk ishin dëgjuar në telefon, sepse ajo ishte në Indi, e babai im pas Luftës së Dytë Botërore në Itali... Nëna Tereze dhe babai im e kishin një gëzim tejet të madh. Përqafoheshin si dikur në fëmijëri...

E shikonin njëri-tjetrin dhe nuk u beson më as syve, as veshëve, as kohës dhe hapësirës, dhe pa fjalë, me lot, me përqafime aq të përmallshme, e pyetnin njëri-tjetrin për vitet e kaluara...

Tema boshte e këtij takimi ishte "Nëna Loke", Drane Bojaxhiu, dhe Ageja, halla ime, të cilat unë kurrë nuk i kam takuar dhe njohur personalisht! Mendoni çfarë pasurdi!

Ata të dytë më shikonin mua, pastaj njëri-tjetrin, pastaj diku në hapësirë, ndoashta edhe drejt Shqipërisë, Tiranës, ku ishte zemra e thyer e dy femrave tashmë të robëruara, të sistemit i cili nuk lejonte kurrfarë kuminikimi familjar, njerëzor...

Nga goja dhe zemra e tyre ngritej vetëm një klithje: O Zot, oj Nëna Loke!!!

Përshtypja ime e parë ishte kjo: një përjetim i jashtëzakonshëm.

Pastaj me kalimin e viteve jemi njohur më për së afërmi nëpërmjet letrave, bisedave telefonike... Gati për çdo vit shiheshim në Romë, sepse ajo vinte gjatë muajit maj për kushtet rregulltare të motrave të saja.

Pas vdekjes së babait tim shkoja unë rregullisht për ta parë në Romë. Marrëdhënia jonë ishte një dashuri e madhe shpirtërore. Ajo nuk ishte si ndonjë hallë klasike... Ishte udhëheqësja ime shpirtërore, me jepte qetësi dhe siguri në jetë...

Pas vdekjes së babait Lazri në janar të vitit 1981, pastaj të Nënës Tereze më 5 shator 1997, çfarë kuptimi kishin për ty këto dy vdekje, ose më mirë të themi këto dy "kalime në amshim"?. Si i ke përjetuar ti?

Pas vdekjes së babait tim kam përjetuar një vetmi dhe zbrazti të madhe, sepse ishim ai, nëna ime dhe unë, nuk kishim më asnjë anëtarë tjetër të familjes... Ishte dhembje e madhe...

Vdekjen e Nënës Tereze e kam përjetuar thellë... Nëna ime Maria ka vdekur në vitin 1993 pas vuajtjeve të shumta...

Kurdo që Nëna Tereze ishte e sëmurë, unë shkoja në Indi për ta parë, për të ndëjur me të në spital, në klinikë, në kuvend. Për

“I lutem asaj si edhe shenjtërve të tjerë, si p. sh. Shën Rozalisë së Palermos..., si shumë shenjtërve apo shenjtëreshave tjera, por kuptohet me një ndjenjë të veçantë. I them asaj kështu: E lumja Nëna Tereze, ti më di, ti më njeh, ti më do, prandaj, edhe më ndihmo!”



Nënë Tereza me mbesën Age Bojaxhiu Guttadauro

mua ishte hiri i Zotit që të rrija së bashku me të për një kohë të gjatë. Luteshim së bashku, bisedonim..., sepse kur ishte mirë me shëndet, nuk kishte kohë për këtë.

Ajo e pranonte vuajtjen me fe, kurrë nuk ankohej, ishte gjithnjë e dëgjueshme. Pati shumë dhembje, vuajtje, sëmundje, por të gjitha i pranonte dhe ishte shumë e disiplinuar me mjekë, me personelin, e përvojatur, e dëgjueshme, e përsosur...

Kur afrohej fundi, nuk mund ta harroj kurrë takimin tonë të fundit, diku katër apo pesë muaj para vdekjes, më tha se ndoshta nuk do të shiheshim më...

Unë i premtova se do të shiheshim në maj në Romë, por nuk shkova, sepse isha e sëmurë dhe me temperaturë.

Në këtë takim shkuan bijtë e mi, Domeniku dhe Maksimiliani. Herën e fundit që jemi parë më tha kështu: "Tashmë do të mbetesh vetëm ti, sepse vetëm ne dyja jemi nga familja jonë Bojaxhiu. Pas vdekjes time do të mbetesh vetëm ti, s'ka më askush nga familja jonë..."

Sytë e saj ishin të përplotur, por edhe plot me shpresë, edhe më tepër me siguri për amshim, jetën e pasosur. Më fliste për kalimin në amshim, apo si i pëlqente asaj të shprehej, "për kthimin në Shtëpinë e Atit", si për ndonjë kalim prej dhomës në dhomë, me aq shumë bindje dhe fe, sa që unë mbetesa e habitur...Më thoshte që së shpejti do të jetë te Zoti me babën Kolë, Nënë Loke, me motrën Age, me baban tim..., me shumë familjarë që unë nuk i njohja fare...

Nëpër sytë dhe zemrën e saj unë, të them kështu, e kam

"parë vetë Zotin", i kam "parë dhe përjetuar" të parët tanë, ata që tashmë e gëzojnë parajsën, amshimin... Për këtë dhe për shumëçka tjetër, unë nga zemra e falënderoj Hallën time të madhe dhe të pavdekshme, Nënë Tereze!

Si është përTy t'i lutesh hallës tënde, të Lumes Nënës Tereze:

Për mua ajo është shenjtëreshë, uroj që së shpejti të shpallet Shenjte. I lutem asaj si edhe shenjtërvë të tjerë, si p. sh. Shën Rozalisë së Palermos..., si shumë shenjtërvë apo shenjtërvë shavë tjera, por kuptohet me një ndjenjë të veçantë. I them asaj kështu: E lumja Nëna Tereze, ti më di, ti më njeh, ti më do, prandaj, edhe më ndihmo!

Çka të ka mbetur Ty si përvojë, si mbresë dhe kujtim nga e madhja Nëna Tereze, Nëna e botës së vuajtjes, e të varfërve ndër më të varfër, ajo që e njihte dhe e dashuronte Jezu Krishtin në çdo njeri? Çka ka mbetur si testament i përvojës tënde me te?

Lidhja ime me të ishte e veçantë. Pikësepari më ka mbetur në shpirt feja e madhe e saj. Unë jam martuar me burrin tim që 42 vjet... Nënë Tereze e kam pasur dhe e kam si pikë orientuese në jetën time. Unë e ndiej dhe e përjetoj se ajo është afër meje, më jep guxim, vullnet për jetë dhe për veprimtari...Unë nuk e bëj të madhe këtë, duke thënë se jam mbesa e Nënës Tereze, për ta pasur ndonjë nderim të veçantë...

Po, ndihem se jam e privi-

legjuar nga ky fakt, nga vetë Zoti, që e pata hallën time, nuk po them si mësuën, por si pikë orientimi për jetën dhe për veprimtaritë e mia.

E ke thënë në fillim se Nëna Tereze e pati këtë dhembje të tmerrshme që për së gjalli të ndahej prej Nënës Drane dhe motrës Age, si dhe për shumë viti nuk dinte asgjë as për vëllaun Lazrin, babain tënd. Këtë nuk ia tregonte gati askujt. Për shpërblimin Nobel në Oslo ishim së bashku një familje shqiptare, Nëna Tereze, Lazri, Ti, Imzot Nikë Prela, unë... Për mua ishte diçka e jashtëzakonshme, heshtja e saj, vuajtja personale, familjare, kishitare, kombëtare... Ajo thoshte se e Premtja e Madhe nuk është mbarimi i Jezu Krishtit, por vetëm nisja e asaj që do të jetë ngjallja, Pashkët. Ti si e përkujton këtë gjendje?

Këtë gjendje e ka përjetuar mbi të gjitha Nëna Tereze dhe babai im. Unë disi e kam përjetuar këtë anash, sepse kurrë nuk e kam njohur gjyshën time Dranen, as hallën time Agen. Aty-këtu kemi shkruar ndonjë letër, e kjo është diçka tjetër. Pastaj në Shqipëri duhej deshifruar atë çka shkruhej, lexohej. Ne dërgonim paketa me shumëçka, barna, gjëra ushqimore, veshmbathje, dhe ato i ndanim në dy pjesë, një për ushtrinë dhe policinë doganore, tjetrën për gjyshën dhe hallën...

Për Nënë Tereze ishte dhembje e madhe e cila duhet ta bënte një zgjidhje tejet të rëndë. Autoritetet e Shqipërisë thonin kështu: Po, ne Ju lejojmë që të hyni në Shqipëri, mirëpo më nuk mund të ktheheni, duhet të mbetni këtu!

(Për herë të parë kam dëgjuar për këtë ngjarje dhe kombinim "djallëzor" dhe nuk di sa mund të jetë e vërtetë. E di se Nëna Tereze, si dhe shumë autoritete të asaj periudhe, si Sekretari i OKB-së U TANTI, kryetari i Francës De GOLLI, i SHBA-ve Xhon Ke-needy, e shumë të tjerë kishin ndërhyrë pranë Qeverisë së Shqipërisë për t'ia lejuar Nënës Tereze hyrjen në Shqipëri, por pa sukses, vrr. Ime).

Dhembja e madhe dhe e vërtetë e Nënës Tereze ishte kjo: ajo duhet të zgjidhte mes të të varfërve, të braktisurve, të mjerëve dhe të gërbulurve, apo Nënë dhe Motrën në Shqipëri. Kjo ishte një zgjidhje tejet e vështirë dhe shumë e dhimbshme...

Këtë vuajtje ajo ia ka ofruar Jezu Krishtit për Kishën dhe popullin në Shqipëri dhe kudo në botë, për botën e të mjerëve...

Nëna Tereze e kishte sigurinë e fesë, kishte një qetësi, si të fliste me telefon me Atin qiellor. Përpos shenjtërisë së saj, mirësisë, gatishmërisë për flimj dhe dhurim, ajo kishte aftësi të mëdha organizative...

Ajo e ka vulosur frymën e saj në "Misionaret e Dashurisë" dhe kështu është dëshmuar madhëria e saj në vazhdimësi. Fatbardhësisht vepra e saj vazhdon edhe më tutje në mbarë botën...

Për herë të parë flet para një publiku që të njeh fare mirë si emër, si mbesa e Nënës Tereze, por tash para kamerës, si të thashë për një film dokumentar mbi Nënë Tereze. Diçka çka

dëshiron t'u thuash njerëzve tanë si mbesa e Nënës Tereze?

Jam gjysmë shqiptare e gjysmë italiane, sepse nëna ime Maria e lind. Sanguini-Bojaxhiu ishte italiane. Mirëpo në brendi, në shpirt ndihem gjithmonë shqiptare, sepse është një pjesë e imja që askush nuk mund t'ma merr. Më vjen keq kur dëgjoj për ndonjë sjellje apo veprim jo të mirë të shqiptarëve, si në Shqipëri, ashtu edhe në Itali, në Kosovë, kudo...

A do të thuash diçka tjetër?

Jo unë nuk jam ndonjë mendimtar e madhe. Jam një person normal dhe kam pasur hirin e Zotit që të jam mbesa e një halle kaq speciale. Shpresoj që vepra e saj do të vazhdojë gjatë shekujve. Ajo thoshte gjithmonë kështu: Nëse Zoti do, vepra ime do të vazhdojë!

Të falënderoj për zemërsisht për këtë bisedë, intervistë. Nëpërmjet teje më duket se i kemi takuar rishas Nënë Tereze, Imzot Nikë Prelën, bacën Lazër si dhe mbarë familjen e madhe dhe të bekuar Bojaxhiu. Edhe një pyetje: Si i ke përjetuar film dokumentarë, artistikë, botimet, fiction mbi Nënë Tereze?

Është vështirë të paraqitet jeta shpirtërore, brendia, thellësia e jetës dhe e veprës së saj. Nëna Tereze e dinte se çka donte dhe e zbatonte gjithmonë vullnetin e Zotit, planet e saj. Ajo kishte guxim të thoshte dhe të ishte vetvetja...

Nga përvoja dhe shërbimi misionar në Indi kishte kuptuar se Zoti është Dashuri, prandaj misioni i saj, por edhe yni, motrave është ky: t'u dhurojnë të gjithëve Dashuri - Zotin. Të gjitha për Zotin dhe për Njeriun, pa dallime...

Ah, gati harrova: Të falënderoj për këto gjashtë vëllime të mrekullueshme kushtuar Nënës Tereze në tri kutia, me plot fotografi, shkrime, përshkrime... Vërtet nëpërmjet tyre Ti ma "solle" sot në Palermo Nënë Tereze, babain tim, Lazrin, nënën time, Marinë, pastaj edhe personat që unë nuk i njoha kurrë personalisht, si "Nënë Loke", Drane Bojaxhiun, hallën time Age Bojaxhiun, e shumë të tjerë!

Tash jam në "shoqëri" të mirë, me këta njerëz të dashur, me Zotin, me burrin tim Giuseppe, apo "Beppe" si e quante Nëna Tereze, me bijtë e mi, me Ty!

Nga zemra të falënderoj për këtë takim, sepse e kemi prekur "damarin e zemrës", jemi shmal-lur dhe freskuar...

Po e përfundojmë takimin tonë me thënien e Nënës Tereze: Zoti na bekoftë!

Palermo, 18. 09. 2008,
Don Lush GJERGJI



Përkujtojmë tri data historike për Gjeçovin

■ SHKRUAN:
Prof. Ismet Elezi

Historia e popullit shqiptar përmban plot ngjarje e figura të shquara që meritojnë të përkujtohen për kontributet e dhëna në fusha të ndryshme të jetës.


Ky vit, viti 2009, përkon edhe me tri data simbolike që kanë rëndësinë dhe vlerat e tyre kushtuar At Shtjefën Gjeçovit, e konkretisht me:

1. 80-vjetorin e vdekjes së tij;
2. 20-vjetorin e përkthimit të *Kanunit të Lekë Dukagjinit* në gjuhën angleze nga kompania botuese Gjonlekaj në Nju Jork (1989);
3. 10-vjetorin e mbajtjes së simpoziumit kushtuar 70-vjetorit të vdekjes së Gjeçovit në Nju Jork (1999).

Të tri këto data janë të lidhura ngushtë me jetën e veprimtarinë e një patrioti dhe intelektualit shqiptar që zë vend nderi në historinë dhe shkencën shqiptare.

1. 80 vjet më parë, në Zym të Prizrenit, At Shtjefën Kostandin Gjeçovi u vra nga shovinistët serbë, për shkak të idealeve dhe veprimtarisë së tij patriotike, sepse kundërshtoi me të gjitha forcat, duke e marrë pjesë aktive në lëvizjet kombëtare kundër padrejtësive dhe synimeve shkombehtarizuese të serbomëdhënjeve ndaj popullsisë shqiptare e kulturës kombëtare. Vdekja e tij ishte një humbje e madhe për kombin e kulturën shqiptare. Shtjefën Gjeçovi njihet për veprimtarinë e tij atdhetare të pandërprerë, që në kryengritjet kundër osmanë në krahinën e Kurbinit më 1906, 1909 – 1912, për pjesëmarrjen në çetat e luftëtarëve të lirisë e për pjesëmarrjen në Kuvendin e Vlorës (1912) etj. Por, Gjeçovi nuk ishte vetëm një atdhetar i flaktë, por edhe një dijetar, etnolog, arkeolog e shkrimtar duke i dhënë kulturës kombëtare veptra me vlerë të madhe.

Shtjefën Gjeçovi është pionieri i mbledhjes nga gojëdhëna popullore të zakoneve e traditave të malësorëve tanë, posaçërisht në Mirditë. Veprimtaria e tij shkencore në fushën e etnologjisë u kororëzua me mbledhjen dhe botimin pjesë-pjesë të normave të Kanunit, fillimisht në revistën "Hylli i Dritës", nga viti 1913 e deri në vitin 1929, kur u vra. Pas vdekjes së tij u përgatit e u botuan *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (1933) nga kleri katolik françeskan i Shkodrës, me parathënien e mrekullueshme të poetit të madh kombëtar At Gjergj Fishtës. Karakteristika themelore e veprës madhore të Gjeçovit, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, është se normat e tij i mbledhi drejtpërdrejt nga



goja e popullit, pranë të cilit jetoi e punoi deri në fund të jetës së tij. Me normat e *Kanunit* malësorët vetëqeveriseshin dhe me to rregullonin të gjitha marrëdhëniet shoqërore në fusha të ndryshme të jetës, marrëdhëniet familjare e martesore, marrëdhëniet e pronësisë, të trashëgimisë, të punës, të vetëmbrojtjes si dhe në fushën penale e procedurale për dhënien e drejtësisë nga pleqtë e zakonit. Natyrisht vendin kryesor në *Kanun* e zinin vlerat e larta etike, morale e shoqërore: nderi, besa, mikpritja, burrëria, falja, pajtimi, gjakmarria etj. Pikërisht për shkak të kësaj përmbajtjeje *Kanuni* tërhoqi vëmendjen dhe interesimin e shumë studiuesve të vendit e të huaj, që nga Johanës G. Hahn (1853), Edith Durham e deri në ditët tona. Por, këto arsye Kanuni u përkthye në gjuhët italiane, gjermane, ruse dhe në gjuhën angleze, duke i bërë një shërbim të madh kombit dhe kulturës sonë kombëtare.

2. Përkthimi i *Kanunit të Lekë Dukagjinit* në gjuhën angleze u bë nga prof. Leonard Fox, me cilësi të lartë. Më 23 tetor 1989, në këtë datë simbolike, që lidhet drejtpërdrejt me At Shtjefën Gjeçovin, Kanuni u botua në gjuhën angleze. Botimi i *Kanunit të Lekë Dukagjinit* në gjuhën angleze u realizua nga kompania botuese atdhetare e mirënjohur Gjonlekaj (Nju Jork). Kjo ishte një ngjarje e madhe për kulturën shqiptare, sepse krijoi mundësi të gjera për njohjen e saj, në një gjuhë kryesore me përmasa botërore në vendet anglistofolëse e në radhë të parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli e më gjerë. Botimi i *Kanunit të Lekë Dukagjinit* në gjuhën angleze u prit me interesim të jashtëzakonshëm, jo vetëm nga rrethet e studiuesve të fushave juridike e etnologjike, por edhe nga

politikanë, historianë, intelektualë të fushave të ndryshme e persona të tjerë. Fakti që janë shpërndarë e shitur me mijëra kopje të tij dhe që ka kërkesa të shumta e të vazhdueshme, është dëshmi e gjallë e këtij interesimi të madh. Shtëpia botuese është e gatshme të plotësojë kërkesat e lexuesve kudo ku e kërkojnë. Të shumta kanë qenë vlerësimet e bëra për *Kanunin e Lekë Dukagjinit* në gjuhën angleze, për kulturën e lashtë juridike të popullit shqiptar. Për këtë janë shprehur me vlerësime të larta presidentë e senatorë të SHBA, gazeta prestigjioze si Nju Jork Times, Washington Post etj., revista të njohura në të gjithë botën, gazetarë, juristë, etnologë e shumë të shumtë të tjerë nga SHBA, Anglia, Kanadaja, Australia e deri nga shkencëtarët nga Japonia e largët. Shkencëtari japonez prof. Kazuhiko Yamamoto ka botuar librin: "Struktura etike e Kanunit dhe nënkuptimet e saj kulturore" (botuar në Amerikë – 2005 dhe në Shqipëri – 2008, anglisht – shqip). Duke folur për sistemin e vlerave etike, midis të tjerash shkruan se: "Siç kemi vënë në dukje dhe në trajtesa të mëparshme, sistemi i vlerave etike të shoqërisë homerike ka pasur strukturë të ngjashme me strukturën e Kodit zakonor shqiptar – kanunit" (këtu është fjala për gjashtë koncepte – besa, nderi, mik, gjaku, buka dhe hakmarria). Këto krahasime janë tregues i lashtësisë së vlerave etike morale të Kanunit shqiptar. Për *Kanunin e Lekë Dukagjinit* brenda dhe jashtë vendit janë botuar veptra dhe artikuj të panumërt (edhe unë personalisht kam dhënë kontributin modest me më shumë se 25 botime), por botimi i tij në gjuhën angleze do të rrisë në mënyrë të pakrahasueshme studiuesit dhe botimet për vlerat e tij. Botimi në gjuhën angleze mund

të shërbejë e të ndihmojë edhe për rininë tonë studentore për njohjen e terminologjisë e të koncepteve që përmban. Ai ndodhet në qarkullim në Tiranë edhe në Prishtinë për ata që dëshirojnë ta blejnë.

3. Më 23 tetor 1999, 10 vjet më parë, në Nju Jork të SHBA, me nismën dhe sponsorizimin e Kompanisë botuese Gjonlekaj, u organizua simpoziumi kushtuar 70-vjetorit të vdekjes së At Shtjefën Konstandin Gjeçovit. Në këtë simpozium morën pjesë shumë bashkatdhetarë të diasporës në Amerikë, studiues – albanologë amerikanë, anglezë, japonezë dhe tre studiues nga Shqipëria, ku bëja pjesë dhe unë, At Zef Pëllumi, Pal Doçi dhe amerikania Kathleen Imholz. Ligjëratat e mbajtura në simpozium ishin të larmishme, ashtu siç ishte figura e madhe e polivalente e vetë Gjeçovit. Të gjitha ligjëratat që vunë në dukje meritat e shquara të Gjeçovit para kombit e kulturës popullore, u pritën me interesim të madh nga pjesëmarrësit e shumë të simpzonium. Për zhvillimet e tij folën "Zëri i Amerikës", radio televizioni "Malësia", gazeta "Iliria" e mjetet të tjera të informacionit. Ato merita ruajnë plotësisht vlerat e tyre dhe tani me rastin e 80-vjetorit të ndarjes së tij nga jeta dhe do të ruhen përgjithmonë. Edhe atdhetari e organizatori i simpoziumit z. Gjek Gjonlekaj ka merita të mëdha për organizimin e shkëlqyer të simpoziumit dhe për mikpritjen tradicionale shqiptare që na bëri jo vetëm neve që shkuam nga Shqipëria, por të gjithë të huajve e pjesëmarrësve të tjerë.

U larguam nga Nju Jorku me përshtypjet më të mira për zhvillimin e simpoziumit dhe me admirim të thellë për popullin amerikan e respekt për diasporën atdhedashëse shqiptare, si dhe me falënderim e mirënjohje për organizatorin, z.Gjonlekaj, i cili bëri të pamundurën të përkujtohej në vendin ku nderohen e respektohen vlerat njerëzore, 70-vjetori i të paharruarit Gjeçov.

Përkujtimi i këtyre tri datave simbolike na shërben për të ruajtur me respekt e nderim të thellë kujtimin e Gjeçovit, që u përpoq e luftoi për çështjen kombëtare shqiptare dhe që na la veprën madhore: *Kanunin e Lekë Dukagjinit*. Në kushtet e sotme të pluralizmit në Shqipërinë e lirë e të pavarur, të shtetit demokratik ku veprojnë Kushtetuta e ligjet demokratike, për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore e juridike, kuptohet se *Kanuni* ka vlera historike dhe ruhet vetëm si monument i kulturës kombëtare, por jo për t'u zbatuar.



Meditim për jetën si përtej detit

(Vështrim për librin e Atë Zef Pllumit „Saga e Fëmijësisë“, botoi Kuvendi Françeskan, Shkodër 2009)

I freskët qëndron mendimi se Atë Zef Pllumi është i mbrami shkrimtar gegë, por edhe më i freskët dhe më i saktë dhe më i fortë qëndron fakti se ai është shkrimtari i vetëm gegë i cili më së miri diti që gjurmët e tij të dhembjes ti vendos në letër.

■ SHKRUAN:
Wilson CULA

Shkrimtari dhe prelati i Kishës Katolike Atë Zef Pllumi pas librit „Rrno për me tregue“ dhe „Histori kurrë të pa degjime“, lexuesit shqiptar i ofrohet me një libër të ri, i cili për nga vëllimi dhe përmbajtja nuk koincidon me dy të parat, por për sa i përket fuqisë së përmbajtjes dhe shtresimit psikologjik dhe vlerës ideo-artistike, qëndron i përafërt me dy vëllimet e para, të cilat për lexuesit tanë tani më janë shumë të njohura. Librit i paraprin një parathënie e studiueses së njohur Ledi Shamku – Shkreli, e cila në hollësi shtjellon fuqinë krijuese dhe rrënimtare të Atë Zef Pllumit ku në hollësi përshkruhet idiolekti dhe arkëtimi i rrënimtarit – autorit siç e quan ajo „mothertongue“ apo gjuha e nanës siç e quante autori Pllumi. I pajisur me përvojat e ndeshtrashave kulturore të viteve të tridhjeta, dëshmitar i disa epokave, njëherësh falë vetë fëmijërisë, rritjes, dhe motimit të tij dhe falë thelbit të tij françeskan, që i njohu si kush më mirë shtigjet për të mbërritur deri tek zemra dhe thelbi i shqiptarizmit, patër Zefi gjatë viteve të tridhjeta përcajtoi në një farë mënyre profilin gjuhësor e kulturor të komunikimit me ne, gjer në ditët e sotme. Duke u nisur nga kjo premisë, nuk është i rastit as nëntitulli i librit „Unë që jetova shumë shekuj“, maksimë që sikur shfaq sinjalin e qartë për lexuesin shqiptar, se sa të mëdha dhe të rënda qenë vuajtjet personale të autorit Pllumi nën regjimin e egër komunist. Edhe pse idiolekti i Atë Zefit paraqet në diakroni të tij shenjat e një arkaizmi të lehtë, pasojë kjo e trashëgimisë historike dhe gjuhësore, porse, të vijuar në formën letrare nga vepra në vepër, na vijnë deri tek „SAGA...“, e cila është shkrimi i brambë përfaqëson në një formë edhe stadin përmblyllës letrar nga ana e tij. Pas një kontributi 16 vjeçar në letërsi 1991–2007, Atë Pllumi i rri besnik rrafshit të koinesë gege, por pa i larguar kurrë rrafshit gjuhësor si në aspektin fonetik, sintaksor, semantik e leksikologjik. Kurse nga rrafshi

semantik vepra e Zef Pllumit „Saga e fëmijërisë sime“, në një mënyrë paraqet psiken kolektive të shqiptarëve të trashëguar përmes shumëkuptimisë së saj. Për sa i përket idiolektit të sagës, ruhet ende fraza e vjetër e semantikes së dyfishtë. Nga kjo mund të thuhet se ky idiolekt i Atë Zef Pllumit përmban në vete përmasën transcendente, duke ruajtur në vete indin e moçëm të gjuhës sonë. Edhe pse i mbjellë në një shekull jete plot vuajtje dhe sakrificë, Atë Pllumi në këtë vepër i ikën modelit të rrëfimit të gjerë, jo nga pamundësia e tij që gjërat e tij personale dhe kombëtare t'i shtrijë në rrafshin ligjërimor, porse lexuesit tonë t'i mundësojë një lexim të shumëstresuar dhe shumëkuptimor, në mënyrë që ai vetë të përballët me imagjinatën e tij dhe me dhimbjen kolektive që e përjetuan autori dhe shumë bashkëkombës të tij. Autori Pllumi veprën e tij e ka konceptuar në gjashtë kapituj apo kapitina, të cilat në vete përmbajnë një model të veçantë rrëfimi, ku përveç portretit ligjërimor dhe personal, shtrihet edhe rrafshi historik, shoqëror dhe faktografik i ngjarjeve.

Në kapitullin e parë të librit „Ardhja në këtë botë“, Atë Zef Pllumi përshkruan lindjen e tij në një vend malor i quajtur „Tërthorja e Bogës“ dhe jetën e pazakontë të malësorëve në ato vise. Aty përshkruhet jeta e tij familjare dhe e asaj krahine, organizimet, mbledhitë dhe gazmendet e kuvendimet e malësoreve, ku çdo tregim mban në vete shtresimet e thella psikologjike të jetës plot sakrificë të malësorëve të veriut. Autori nuk le pa përmendur edhe veset dhe dobësitë e njerëzve të kësaj krahine, të cilat ndodhi i merr si të natyrshme sikurse është shumë e natyrshme dhe origjinale fuqia rrëfyese e tij. Kurse në pjesën e dytë „Rrena e parë“, autori përshkruan jetën e tij fëmijërore kur ai ishte vetëm 3-vjeçar dhe dëshirën e tij posive për të përfutur gjëra ushqimore dhe materiale nga ekonomia familjare. Këtu na del se nëna e tij ishte e rreptë me të dhe ndaj tij, kurse babai mjaft tolerant dhe përkrahës ndaj

Prekës së dikurshme, e tani Atë Zef Pllumi shkrimtar. Mu kjo përkrahje e babait të tij, shikuar nga aspekti psikologjik, ndoshta do bëhej shkas i një formimi të fortë të personalitetit të Atë Zefit si karakter, i cili arriti t'i rezistojë vuajtjes dhe regjimit komunist për katër dekada. Pjesa e tretë „Dëshira me u ba frar“, autori dëshmon se familja e tij ishte e mekamur shumë ekonomikisht dhe se axha i tij Pashko Toma, falë autoritetit të tij dhe angazhimit të tij kombëtar, gëzonte një autoritet të madh në rreth andaj edhe kontakti me frerët nuk i mungonte. U bë shkas një vizitë e fratr të Lezhës Bona Gjeqaj në shtëpinë e Pashko Tomës që Prekës së vogël t'i ngjallej dëshira dhe imagjinata për t'u bërë frar. „A do bahesh frar kur të rritesh“ i kishte thënë Atë Gjeqaj vogëlushit. „Po“ i kishte thënë me vendosmëri djaloshi i vogël. Autori dëshmon: „këtë dëshirë e kam ushqyer që në moshën tri apo katër vjeçare“, por ky qëllim i ishte përfurcuar siç dëshmon ai kur e kishte parë dhe takuar për herë të parë Atë Gjergj Fishtën.

Kjo kishte ndodhur mu në shtëpinë e prindërve të tij, kur Fishta dhe Anton Harapi kishin ardhur për vizitë në ato vise. Pjesa e katërt „Arratisja nga shtëpia“, përshkruan situatën imagjinare të një fëmije për ta zënë diellin, atë diell, i cili e ngriti deri në majat e malit dhe i iku prapa horizonteve. Është kjo fuqia e rrëfimit të autorit përmes parabolës së situatës, e cila e shoqëron tërë tekstin e tij. „A nuk ishte vallë e tillë edhe jeta e autorit? Nata djaloshin e kishte zënë në kasolle dhe pas një alarmimi të familjes dhe fshatit, atë e kishin gjetur në stan duke qëndruar i vetëm. Më pas përshkruhet vizita e bërë kishës së Shën Antonit në Laç së bashku me familjen dhe rënia në kontakt me priftin gjerman Don Alfonsin, i cili me miratimin e babait të vogëlushit Prekë, e mori djaloshin e vogël për të jetuar në kishë, ku aty mësoi shkrim e lexim edhe pse moshë e tij ishte vetëm katër vjeçare. Autori nuk le pa përmendur edhe bujarinë e sivëllait të don Alfonsit, zotëri Hansit, i cili për aq kohë sa qëndroi vogëlushi Prekë, në



atë vend, u kujdes për të si për fëmijën e tij. Në pjesën e pestë „Pranimi në koleg“ rrëfëhet për djaloshin e vogël, i cili pranohet në kolegjin françeskan në moshën shtatëvjeçare. Autori i veprës dëshmon se kontaktin e parë në kolegji e pati me Atë Anton Harapin, i cili edhe e kishte orientuar për t'u pranuar në kolegjin françeskan. Atë Antoni kishte kërkuar kushte dhe disiplinë të rreptë nga ana e djalit të vogël, përndryshe do ta kthente në shtëpi. Një pjesë e veçantë dhe mjaft e ndjeshme në këtë kapitull përshkruan edhe momentin aq të prekshëm dhe pikëllues të nënës së Atë Zef Pllumit, e cila e lënduar shpirtërisht, vendos ta le djalin e saj në kolegji dhe, siç thekson autori, nena e tij ia kishte përsëritur këto fjalë shumë herë në jetë. Në pjesën e gjashtë „Me Atë Gjergj Fishtën“, përshkruhet jeta e françeskanëve në vitet e 30-ta, vit kur qeveria e asaj kohe kishte dhënë urdhër për mbylljen e të gjitha shkollave private e ku këtë fat e përjetoi edhe shkolla françeskane. Autori dëshmon edhe faktin se si në vitet 1929 dhe 1930 është bërë incizimi në pllaka gramafoni të dy këngëve të Lahutës... si „Te Kisha e Shnojit“ dhe „Vranina“, ku autori tani shpreh dyshimin se pllakat e ditëve të sotme të rinçizuara nuk kanë të bëjnë

me regjistrimin e zërit të vërtetë të Fishtës. Një moment shumë të veçantë autori e çmon rastin kur vetë autori i Lahutës së Malësisë ia dhuron Atë Zefit librin së bashku me autografin e tij mbi te. Ditë të tmerrshme autori Pllumi e llogarit në dhjetorin e vitit 1946, kur bastiset Kuvendi françeskan nga regjimi komunist, por veten prapë e ndjen të lumtur që arriti ta shpëtonte ekzemplarin e Lahutës dhe shkopin e bukur të atë Gjergj Fishtës, relikte, të cilat në vitet e demokracisë ia pati dorëzuar Muzeut etnografik të françeskanëve. Edhe pse ky libër i Atë Zef Pllumit i takon zhanrit autobiografik dhe për nga vëllimi, përmbajtja dhe përshkrimi i situatave nuk i plotëson disa kritere rrëfimorë, lirisht mund të themi se ky libër hyn në radhën e librave më të vlefshëm autobiografikë të shkrimtarëve tanë, të cilët për një jetë të tërë bartën mbi vete vullën e dhimbjes shekullore.

Nga gjithë kjo që u tha gjer më tani për librin e Atë Zef Pllumit, lirisht mund të konkludojmë, edhe pse ende qëndron i freskët mendimi se Atë Zef Pllumi është i mbrami shkrimtar gegë, por edhe më i fortë dhe më i saktë qëndron fakti se ai është shkrimtari që jashtëzakonisht bukur i paraqiti në letër gjurmët e tij të dhembjes.

"Ja, Virgjëra do të ngjizë..."

"Ja, Virgjëra do të ngjizë e do të lindë një djalë e për emër do ta quajë Emanuel" / Is 9, 146/.

"Qe, Virgjëra do të mbesë shtatzënë e do të lindë një djalë, të cilit do t'ia ngjisin emrin Emanuel që do të thotë: hyji me ne!" / Mt 1, 22-23/.

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJ

Këtë ngjarje tejet të rëndësishme dhe vendimtare për fatin e mbarë njerëzimit e kishte "paralajmëruar" Isaia profet, pastaj e kishte ripërtërirë edhe Mikeu profet, kurse më vonë e kanë përpunuar dhe shkruar në hollësi edhe ungjilltari Mateu, por edhe Luka /krh. Lk 2, 1-7/.

Teksit i Isaisë lypset shpjeguar dhe interpretuar në kontekstin historik, që është shkruar në vitin 734 para Krishtit, në kohën e rrezikimeve të mëdha për Izraelin nga Siria, si dhe nga Asiria.

Pikat kryesore të këtij premtime janë këto:

Lindja e një djalë-fëmije

Kjo lindje do të ndodhë prej një gruaje të re, hebraisht **almah** që dmth. një grua e re, e cila ende nuk ka lindur dhe që mund të jetë e pamartuar apo e martuar.

Hebraisht virgjëra shënohet me një term tjetër – **betulah**.

Mirëpo, ky premtim ka tejkaluar kohën dhe hapësirat hebraike dhe në historinë e shëlbimit gjithnjë është shpjeguar dhe shqyrtuar si paralajmërim mesianik i lindjes së Jezu Krishtit nga Virgjëra Mari.

Emri i djalit që do të lindë është Emanuel

Ky emër ishte shpresëdhënëse, sepse Jahwe është dhe do të jetë gjithnjë me popullin e vet për ta mbrojtur, përkrahur dhe udhëhequr nga armiqit e ndryshëm.

Jezusi, Emanueli i vërtetë në histori dhe gjithnjë, do ta zbulojë dhe dhurojë mirësinë, dashurinë dhe faljen e Hyjit për mbarë njerëzimin. Kështu më njeriu nuk do të jetë nën barrën e vdekjes dhe të së keqes, por i aftë për liri dhe përgjegjësi, kuptohet, gjithnjë në bashkëpunim me Zotin dhe me të afërmin.

"Do të ushqehet me mazë e me mjaltë derisa të mësojë të flakë të keqen e të zgjedhë të mirën" / Is 7, 15/.

Sipas shpjegimeve historike kjo ka ndodhur sepse fshatrat pjellore ishin të shkatërruara dhe populli ishte i detyruar të tërhiqej nëpër male me bagëti dhe s'kishte ushqime tjera. Mjalti dhe qumështi janë edhe simbolet e Tokës së Premtuar, si dhe të plleshmërisë dhe të lumturisë, kurse maza dhe mjalti ishin ushqime të thjeshta për të varfër.

Ardhmëria e fëmijës – djalit

Deri sa mos të mësohet dallimi mes të mirën dhe të keqen, mosha e arsyes apo e pjekurisë, dy mbretëritë e tmerrit, Siria dhe Samaria, do të shkatërrohen me njëri-tjetrin dhe do të ketë qetësi dhe paqe për Izraelitë.

EMANUEL, nuk është më ndonjë godinë, ndërtesë apo tempull, vend, por do të jetë

"Shtëpia e Davidit", ndërsa fjalën MESIA, i Shuguruari i Hyjit, Mateu e rilexon dhe e trajton nëpërmjet lindjes së Jezu Krishtit – Zoti me ne!

Kështu gruaja e re, nëna e Elizabetës, interpretohet si paralajmërim i Virgjërës Mari, ndërsa Isaia interpretohet si paralajmëtar apo profeti i Jezu Krishtit, apo siç thonë disa si "ungjilltari" i Besëlidhjes së vjetër.

Këto dëshmi të lashta i gjejmë edhe në katakombet e shën Prishillës në Romë / shekulli i dytë pas Krishtit/, ku paraqitet Virgjëra Mari me Jezusin Fëmijë, dhe në shoqëri me ta edhe profeti Isaia.

Shumë etër të Kishës perëndimore dhe lindore, prej Justin, Tertulianit, Ciprianit, Atanazit, Cirilit të Jerusalemit, Bazilit, deri te Ambrozi, Jeronimi etj. e kanë interpretuar Isainë si profet të Jezu Krishtit.

"Populli që ecte në errësirë, pa një dritë të madhe; për banorët

që jetonin në krabinën e hijës së vdekjes, zbardhi për ta drita" / Is 9, 1/.

Edhe vetë Jezu Krishti ndërlihet me profecitë e Isaisë duke e cituar atë thotë kështu:

"Shpirti i Zotit është mbi mua, sepse Zoti më shuguroi, më dërgoi t'ua sjellë të përvojaturve lajme të gëzueshme, t'i shëroj ata që kanë zemrën e plasur,

t'u shpall shpallëvërve lirinë, të burgosurve çlirim, ta shpall vitin e birit të Zotit..." / Is 61, 1-2; Lk 4, 18-19/.

Jezusi pasi e lexoi këtë profeci, e shpjegoi dhe komentoi kështu: *"Sot shkoi në vend kjo pjesë e Shkrimit shenjt që e dëgjuat me veshë tuaj" / Lk 4, 21/.*

Me lindjen e Jezu Krishtin, Shëlbuesit të botës, mbarë njerëzimi përfundimisht do të ketë mundësi të jetë i lirë prej robërisë së Djallit, mëkatit dhe vdekjes dhe do ta ketë mundësinë e shëlbimit.

Fjala e atër Ndue Kajtazit në festën e shën Katarinës në Pejë

Sot kisha katolike feston martirien e Aleksandrisë, shën Katarinës. E gjithë jeta e saj është një sakrificë e madhe për fenë e krishterë dhe për Krishtin.

Martirizimi i saj ndodh në kohën e perandorit Dioklecian. Sikur u martirizuan shumë të krishterë në atë kohë, edhe kjo vajzë shkoi gjurmëve të njerëzve të shenjtë. E derdhi gjakun e vet për të vërtetën dhe fenë e shenjtë.

Para se t'a vrisnin provuan shumë njerëz të dijsëm pagan ta bindin se ajo beson në një Zot të rrëshëm, se Krishti s'mund të jetë Zot, nëse vdiq në kryq.

Ajo ishte e bindur në besimin e vet, dhe këtë besim ajo e njihte shumë mirë, kështu që i përgjigjej me sukses çdo pyetje që i shrohej rreth figurës së Krishtit. Ajo edhe i bindi ata dijetarë se Krishti është i Biri i Hyjit, dhe se Ai nga dashuria e pafund e Atit Zot erdhi në botë që të lante borgjin e krejt botës me gjakun e vet.

Edhe sot kemi njerëz e besime të ndryshme që e mohojnë këtë të vërtetë, se Krishti kinse nuk vdiq në kryq. Po ja hoqe Krishtit kryqin, ja hoqe Mbretit të Amshueshëm fronin e vet, andaj më Ai nuk është mbret, as nuk është Krishti i vërtetë.

Kështu në Romë para pak ditësh kishte deklaruar edhe Gadafi kur e mbajti një ligjer-

atë para vajzave të Romës, dhe u thotë: "Kthehuni në islam, e mos e besoni se Krishti është kryqëzuar. Krishti është ngritur në qiell pa u kryqëzuar".

Ku janë ato vajza që duhet t'i përngjajnë shën Katarinës e t'i përgjigjen për besimin e tyre?

Kështu çdo vajzë dhe çdo i ri duhet t'i përngjaj Katarinës së Aleksandrisë e t'i përgjigjet 50 vetëve e t'i bind edhe ata: që gjaku i Krishtit u derdh për krejt njerëzimin. Dhe se Mbret i mbretërve dhe Sundimtar i sundimtarëve që do të gjykon Qielin e tokën është Jezu Krishti. Dhe se çdo njeri që i beson emrit të Krishtit do ta gjej shpëtimin dhe shëlbimin.

Çështja e Krishtit është çështje që ka të bënë me të vërtetën. Sepse ashtu i përgjigjet Krishti edhe Pilatit: "Unë leva dhe erdha në botë për të dëshmuar të vërtetën. Kush e do të vërtetën ai e dëgjon fjalën time". (Gjn 18:37b). "E pra unë nuk erdha prej vetvetës: por është Një i Vërtetë që më dërgoi..." (Gjn 7:28b). "Nëse do ta mbani fjalën time vërtetë do të jeni nxënëse të mi; do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bën njerëz të lirë" (Gjn 8:31b-32a).

Pra e tillë ishte Katarina e Aleksandrisë, ajo që e mbajti fjalën e Krishtit dhe e njofti të vërtetën. Kjo e Vërtetë e bëri njeri të lirë.

Vazhdimisht po flasim për të

vërtetën dhe derisa nuk do ta njohim atë, dhe nuk do ta pranojmë ne do të jemi njerëz të prangava, njerëz të ngujuar në qullin e gënjeshtërisë.

Sa shpesh gjatë historisë njerëzve me dhunë e me mjete të tjera u është iponuar e pa vërteta, u është sërëuar si e vërtetë, dhe bijtë e tyre kanë mbetur njerëz të prangava dhe të ngatërruar në leqet e gënjeshtërisë.

Njeriu duhet ta ketë forcën e shën Katarinës të dalloj të vërtetën prej gënjeshtërisë, edhe kur gënjeshtria të servohet me argumentin e forcës.

E cila është forca e argumentit të besimit të krishterë?

E vërteta është kjo forcë. E vërteta na flet se krishterimi u mbjell dhe u rrit në gjakun e derdhur të Krishtit dhe të krishterëve kudo, prej fillimit deri sot.

Pra krishterimi i ka rrënjët në gjakun e vet.

Apo ndoshta sot njerëzit nuk ndjejnë nevojën për këtë të vërtetë, ndoshta kjo e vërtetë nuk ju intereson fare?

Po po ka shumë njerëz në veqanti në Perëndim se nuk ju intereson fare kjo punë. Nuk mirrën më të, dhe sikur Nitchë shpallin: Zoti ka vdekur!

E sa herë i mbyllim sytë dhe veshët që mos ta dëgjojnë të vërtetën, gënjeshtria dhe e pa vërteta na servohen dhe ato i marrim si të vërteta pastaj.

E vërteta bjen viktimë shpesh kur qarqet të ndryshme gatuajnë gënjeshtria që ta mbajnë një popull në pranga.

Të tillë jemi ne shqiptarët e mjerë.

A nuk po na servohen gënjeshtria të tilla për figurat më të ndritura të kombit tonë?

Servohen gënjeshtria dhe shtrëmberohet figura kryesore, me e ndritur e këtij populli, figura e Gjergj Kastriotit.

Shkohet aq larg sa thonë se ai e ka shkatërruar popullin e vet, se me mirë do të ishte sikur mos të kishte bërë fare rezistencë turkut, e ne tash do të ishim në numër më të madh! Natyrisht turq apo çka di tjetër?

Servohen gënjeshtria dhe shtrëmberohet edhe figura më e ndritshme e shek. XX, Nënë Tereza. Dikush pati marr guxim të thotë: se shpirti i saj tash digjet në ferr!!! Dikush tjetër se ajo nuk është fare shqiptare, se ajo kurr s'ka shkelur tokën e Kosovës etj.

Më çfarë qëllimi thuhën këto gjëra të tmerrshme?

Vetëm që ta zbehin të vërtetën e të krijohet mjegull e gënjeshtres që ky popull të mbetet në errësirë e bishat e malit ta bëjnë prë.

Mohimi i të vërtetës është mohim i vetvetës.

A nuk e mohuam ne shqiptarët vet Gjergj Kastriotin?

A nuk e mohuam në vet Pjetër

Bogdanin?

A nuk e mohuam ne vet Gjergj Fishtën?

A nuk e mohuam ne vet edhe Lorenç Mazrekun, eshtrat e të cilin janë në këtë kishë?

A nuk e mohuam ne vet Ibrahim Rugovën?

Në fund të fundit, a nuk e mohuam ne shqiptarët vet Krishtin?

E fati i nxënësit (Judës) që e mohoj Krishtin dhe e tradhëtoi atë, dihet. Ai përfundoi në litar. U var me duar të veta.

Dhe secili që e mohon të vërtetën gërshton litarin që të varet me duar të veta. Ai njeri shkon gjakdhumbur!

Andaj figura e Katarinës së Aleksandrisë na flet sot të gjithë neve këtu.

Edhe në vuajtje, edhe në sakrificë, edhe në salvine, edhe në vdekje nuk guxojmë t'i bijmë mohit të vërtetës. E vërteta do të na bën njerëz të lirë!

"Përnjëmend, përnjëmend po ju them, thotë Krishti: Nëse kokra e grurit e mbjellë ne dhe nuk vdes, jet e vetme; po nëse vdes jep shumë fryt. Kush e do jetën e vet do ta humbë, e ai që e jep jetën e vet për mua, ai do ta ruaj për amshim". (krh. Gj 12:24).

Prap Krishti thotë: "Unë jam Udhë, e Vërteta dhe Jeta. Askush nuk shkon tek Ati pos nëpër mua. Nëse më njohët mua, do ta njihni edhe Atin". (Gjn 14:6-7a).

Amen!

Edukimi për dashuri

■ SHKRUAN:
Mihály SZENTMÁRTONI

Miqësitë heteroseksuale dhe dashuria e parë e të rinjve, u përkasin edhe prindërve edhe edukatorëve. Prindërit në përgjithësi janë të brengosur për shkak të rrjedhjes dhe ardhmërisë së asaj lidhjeje. Ose u duket lidhja ende tepër e hershme ose i kundërshtojnë lidhjes me personin e caktuar. Në çdo rast, shkaqet e tyre duhet t'i paraqesin në mënyrë të qetë dhe të përkohshme. S'guxojnë të bien në gabim se mikun ose mikeshën dëshirojnë ta largojnë në mënyrë jo objektive: me turpërim, nënçmim apo ngjashëm. Nuk guxojnë të krijojnë skena emocionalisht të ngujuara as të krijojnë gjendje vazhdimisht të ngrirë në shtëpi. Kjo më së paku çon në zgjidhje. Prindërit do të sillen më me mençuri nëse e thërrasin në shtëpi mikun ose mikeshën, sepse nëse i kundërshtojnë kësaj, me siguri do ta humbin plotësisht mbikëqyrjen mbi të birin ose të bijën. Qëndrimi nga më i përshtatshmi jo rrallë herë është pritja. Në raste të shumta, lidhjet e para shkatërohen vetvetiu pas një kohe të shkurtër. Por, edhe nëse nuk bëhet kjo shkëputje, prindërit parimisht nuk kanë të drejtë me metoda të shtrëngimit t'i ndajnë të rinjtë dhe të përzihen në situata vendimtare të jetës dhe në vendime jetësore të të rinjve. Aq më tepër që për njëzetvjeçarët është e rëndësishme për jetë që ndërmjet tyre dhe prindërve të ekzistojë atmosferë besimi (mbështetjeje). Me atë rast kurrë s'guxojnë nga kureshtja e kulluar t'i pyesin (shqyrtojnë) fshehtësitë e të rinjve - kjo, sigurisht, do t'i prishë të gjitha.

Kisha, përkatësisht mësimdhënësit e fesë, katekistët e të rinjve, gjithashtu e kanë pjesën e vet të detyrës dhe të përgjegjësisë për të rinjtë, të cilët pikërisht atyre shpesh u drejtohen me problemet e tyre e të qenit i/e dashuruar. Ndoshta sot më pak, mirëpo ende para disa viteve mjaft është dëgjuar mendimi se Kisha do të duhej të ishte më tolerante ndaj marrëdhënieve paramartësore të të rinjve të dashuruar, kurse parimi i gjykitimit do të ishte dashur të jetë ky: „Nëse duheni në mënyrë të vërtetë, mund të keni marrëdhënie, vetëm ruajuni nga shtatëzënia!“ Ky parim, përveç se nuk është origjinal, s'është as i bazuar psikologjikisht. Përkundrazi, marrëdhëniet paramartësore janë gjithmonë shenjë e dashurisë jo të plotë. Do të provojmë këtu sërish ta formulojmë këtë pyetje, mirëpo jo



aq në formë të problemit sa në formë të detyrës edukative.

Pyetja e marrëdhënieve paramartësore më së shpeshti „zgjidhet“ sipas pohimit se parimisht nuk janë të lejuara. Pra, jepet ndalimi pa arsyetimin e atij ndalimi. Dhe e dimë se pikërisht ndalime të tilla më së shumti e gëcilojnë fantazinë. Tek të rinjtë edhe pa dashje paraqitet pyetja pse s'do të guxonin të bënin diçka për çfarë janë të aftë, por që të rriturit përndryshe e bëjnë. Në vend të kësaj, për praktikën edukative duhet shpjeguar më së pari thelbin e dashurisë seksuale, e që atëherë të numërohen kërkesat morale.

Të rinjtë duhet ditur se vetpërmbytja paramartësore nuk kërkohet prej tyre, për arsye se diçka dëshirohet të merret prej tyre, diçka të refuzohet ose të ndalohej, por që t'u ndihmohet që të arrijnë të dashuria e plotë. Lumturia martësore, domethënë, nuk është fryt ekskluzivisht kënaqjeje e instinktit seksual, por e kontaktit të plotë personal. Dashuria e vërtetë, barazi mendon për tjetrin si për veten. Kësaj i përket edhe dëshira që të gjitha t'i përfetojnë së bashku, që gjithçka të kenë të përbashkët, që të gjitha vështirësitë t'i pranojnë së bashku. Shkurt, që më të mos ketë asnjë pengesë ndërmjet tyre. Mirëpo, dëshira nuk është e mjaftueshme. Janë të nevojshme

edhe mundësitë konkrete që ajo dëshirë të realizohet. Porse ato mundësi nuk bien nga qielli në prehër, as që i mbart pjekuria seksuale: ato duhet realizuar.

Më tutje, dashuria e vërtetë dëshiron së bashku të pranohen pasojat që lindin prej saj. Së këndejmi, vijon argumenti kryesor kundër marrëdhënieve paramartësore: ky është mëkat kundër dashurisë (e jo vërtetimi i saj), sepse partnerët, në të vërtetë, së bashku ndajnë gëzimin e marrëdhënieve, mirëpo barra që rrjedh prej saj ndahet në mënyrë jo të barabartë. Djaloshi që dëshiron vetëm ta kënaqë dëshirën e vet seksuale në thelb nuk e do vajzën, por vetveten. Përveç kësaj, sille në mënyrë egoiste kur tërë përgjegjësinë për pasojat i hedh në vajzën. Shumë të rinj (djem) nuk kanë gati kurrfarë lidhjeje se çfarë kërket e kushtëzon marrëdhënia seksuale në vajzën. Ajo ndoshta me javë ose me muaj do të jetojë nën barrën e drojës, edhe atëherë kur për të nuk bëhet e vetëdijshme. Të rinjtë duhet shpjeguar se vajza që jeton gjatë nën barrën e asaj droje, as më vonë më nuk do të mund ta gjejë bukurinë e jetës së përbashkët.

Pra, në vend të ndalimeve parimore, të rinjtë duhet ta kuptojnë se përmbytja paramartësore nuk është pengesë e dashurisë, por, përkundrazi, ajo është par-

akusht për një lulëzim të plotë të dashurisë në martesë. Natyrisht, këtë „dituri“ (dije) nuk mund ta marrim si mbrojtje absolute. Çdo çift i dashuruar përjeton momente, në të cilat çdo dituri shkatërohet. Atëherë, më sa duket, ende vetëm hiri i Hyjit i ruan...

Për sa i përket rolit të Kishës në edukimin e të rinjve për dashuri, ekziston mendimi interesant se nuk ka një domethënie në porosinë e vet. Këtë mendim e ka shtruar H. Helle, profesor i sociologjisë në Universitetin e Mynihut. Sipas mendimit të tij, kur fillon pjekuria seksuale, të rinjtë në mënyrë progresive e lëshojnë familjen dhe kërkojnë kontakte shoqërore. Mirëpo, në atë kërkim nuk është në plan të parë takimi me personat e seksit tjetër si me partnerin e mundshëm martësor, por në ta të rinjtë në të vërtetë kërkojnë anëtarët „e humbur“ të familjes së tyre primare: i vlerësojnë në krahasim me atin, nënën, vëllezërit ose motrat. Helle mendon se kujdesi i Kishës rreth të rinjve do të ishte dashur të drejtohet që një shikim i tillë të përfordhet. Të rinjtë duhet shpjeguar më së pari në gjendjen e vërtetë të pamartësës, d.m.th. te një gjendje e tillë shpirtërore që rrethinën, njerëzit e vet të ketë mundësi t'i takojë si anëtarë të familjes së vet.

Sado që ky mendim në shikim

të parë të duket i pranueshëm, ndoshta madje i krishterë, ai fshih brenda vetes një rrezik. Në qoftë se personave u afrohet në rend të parë në bazë të perceptimit të cilësive vëllazërore ose motërore një lidhje e tillë ngarkon si një „incest psikologjik“ i caktuar. Ndërkaq zgjedhja e vërtetë e parterit mund të fillojë vetëm atëherë nëse nuk ekziston më kurrfarë hije e tabusë së incestit. Shenja për një pjekuri të tillë është ndryshimi në perceptim: kur fillon për të parë në partnerin e vet të atin përkatësisht nënën e fëmijës së përbashkët të ardhshëm. Kjo garanton se në partnerin më nuk e projekton marrëdhënien e vet ndaj prindërve. Vërtetim i zhdrejtë për atë kuptim e kemi edhe në analizën e zhvillimit emocional të vajzës. Vajza nuk e ndien veten të plotë, derisa nuk arrin ta përjetojë se është e dashur. Kur ta ndiejë dashurinë, lidhjen dëshiron ta bëjë të përhershme dhe të lindë fëmijë.

Kisha mund dhe duhet që të rinjtë t'i drejtojë kah dashuria e pjekur. Mendoj se tepër pak e shprehim dhe e përdorim nocionin „e krishterë“ të dashurisë. Pikënisja më e përshtatshme është definicioni i Palit i dashurisë në Letrën e parë drejtuar Korintasve:

Dashuria është zemërgjerë, dashuria është e dhimbshme; dashuria nuk ka smirë, nuk mbahet në të madh, nuk krenohet, nuk është e panjërëzishme, nuk e kërkon interesin e vet, nuk hidhërohet, nuk e mban mend të keqen; nuk i kënaqet padrejtësisë, por i gëzohet së vërtetë; arsyeton gjithçka, beson gjithçka, shpreson gjithçka, duron gjithçka. Dashuria nuk mbaron kurrë.

Ky definicion, pohojnë teologët, në origjinal përmban 15 folje, që është shumë vështirë, po ashtu edhe emrat, të përkthehen në gjuhët bashkëkohore. E pra, thelbi qëndron: dashuria është aktivitet, kthim vepres kah partneri. Prandaj si test i pjekurisë së një dashurie, do të mund ta përdorim pikërisht definicionin e dashurisë së Palit. Vetëm kur janë të gatshëm dhe të aftë djali dhe vajza pozitivisht të përgjigjen në të gjitha pesëmbëdhjetë kërkesat e dashurisë, mund të thuhet se janë të gatshëm për një jetë të përbashkët.

(Përktheu:
P. Shjefën Dodes SJ)

Zgjedhja e thirrjes – përcaktim për një jetë më të mirë

■ SHKRUAN:
m. Hana Kqira

3. Kush janë të rinjtë dhe kur është koha për vendim?

Të rinjtë tanë gjenden para zgjedhjeve jetësore shpeshherë të lënë në mëshirë e fatit dhe duke u ballafaquar me krizat jetësore pa kurrfarë ndihme apo kritere. Shpeshherë ata e ngatërrojnë realitetin me botën virtuale dhe imagjinues. Për këtë është e pamundur që mos të angazhohemi dhe të obligohemi ta njohim botën e tyre më trenjesisht, etapë e zhvillimit dhe dëshirat e aspiratave të tyre.

Nuk është lehtë të njohim këtë botë, sepse duke tentuar të fotografojmë apo përshkruajmë, analizojmë dhe interpretojmë realitetin ku jetojmë nga ndërrimet e shpejtuar, në fund të analizimit me rezultate, gjendja veç është e transformuar dhe e modifikuar në diçka tjetër. Në disa raste, zgjedhjet e të rinjve nuk janë të orientuara nga një ideal, apo vlerë, apo ndonjë e prituri ekzistenciale dhe domethënëse por është një zgjedhje për të zgjedhur. Të rinjtë janë të tërhequr më shumë nga instinkti emocional apo interesat momentale apo dëshirojnë të jenë konformistë dhe të veprojnë si të tjerët. Pra, zgjedhjet bëhen për t'u bërë, jo se ata atëherë e ndiejnë momentin e volitshëm as që kanë kushtet fizike, psikike dhe ekonomike. Pra, edhe pse nuk ndihen të aftë, por duhet të zgjedhin, sepse kështu bëjnë të gjithë. Nuk është më rëndësi që pas një kohe do të pendohen për zgjedhjen që kanë bërë dhe të kthehen prapazi. Pra, shpeshherë ndodh që në qendër të zgjedhjes të janë përvojat, apo eksperimentimet e gjërave të reja, të cilat i shpijnë ata në vështirësi për një zgjedhje koherente me projektin e jetës. Pastaj të rinjtë kanë vështirësi t'u dhurohen dikujt e nëse e bëjnë, një pjesë e rezervojnë për eksperimentime të mëtejshme pa i definuar kurrë kufijtë. Në marrëdhënie tentojnë të negociojnë. Pastaj është shumë i pranishëm edhe fenomeni i qëndrimit të zgjatuar në familje dhe papjekuria personale, të cilat nuk janë faktorë të vetëm që influencojnë mbi projektet personale apo zgjedhjen dhe kështu të arrijnë më në fund të bëjnë pjesë në botën e njerëzve të rritur dhe të pjekur. Shpeshherë kjo gjeneratë e re është e «etiketuar» vetëm nga gjërat negative siç janë: dobësia dhe thyeshmëria e tyre, por mbi të gjitha nevojitet t'i shikojmë gjërat pozitive dhe sfidat që na ofrohen. Pra, të rinjtë janë personat me të cilat mund të krijohet një botë më të mirë dhe më të lumtur.

Cila është mosha kur një i ri/e re përgjigjet thirrjes?

Shpeshherë pyetemi kur është koha më e volitshme për një

zgjedhje të tillë: kur jemi fëmijë, në shkollë të mesme, në fakultet, apo kur veç kam arritur një pjekuri dhe kam një profesion? Sigurisht që është më së miri të përgjigjemi kur Zoti na thërret, as përpara as prapa. Nëse e ke vu re se të thërret pa marrë parasysh në cilën moshë atëherë pse të presësh? E nëse thirrja jote nuk është e pjekur pse atëherë paraprindë? Por mendoj se çdo moshë ka elementet pozitive dhe negative. Janë pyetje të cilat askush nuk e ka lehtë t'i u përgjigjet, dhe nuk vijnë në mënyrë spontane. Por si ta di se me të vërtetë po me thërret Zoti? Ndoshta është një iluzion, një ëndërr kaluese apo ndoshta është një bindje dhe një e vërtetë? Thirrja në të vërtetë është e Atit, por jo edhe përgjigja. Ajo është e secilit person konkret dhe këtë nuk mund ta bën askush për mua, për ty...! Pra, përgjigja duhet të bëhet konkrete në një dhurim total dhe ekskluziv. Bëhet eksperiencë personale në dashuri ndaj Krishtit dhe vëllait njeri.

4. Ndikimi i grupit apo shoqërisë në zgjedhjet e të rinjve

Sipas studimeve dhe analizave të bëra, të rinjtë kalojnë shumë kohë së bashku si në ambientin shkollorë, gjithashtu gjatë kohës së lirë. Në këtë mënyrë ato ballafaqohen së paku me dy vështirësi kryesore: vështirësitë të formojnë një identitet individual dhe atë autonom. Të rinjtë sot tregojnë një interes të madh për jetën e grupit si dhe për format e ndryshme të të jetuarit së bashku.

Sipas studimeve të bëra mbi kushtet shoqërore e kulturore të rinjve e adoleshentëve në vitet e fundit sidomos në kontestin evropian, është e mundshme të kemi një evidencë mbi marrëdhëniet e të rinjve. Janë dy elemente më të shpeshta që karakterizojnë jetën aktuale të të rinjve: jeta e përbashkët dhe përkatësia e një grupi.

Koha e kaluar së bashku, miqësia dhe grupi shkojnë paralelisht në tërë kohën e adoleshencës dhe rinisë. Pra, miqësia është një element konstitutiv dhe bëhet një ndër vlerat më të mëdha jetësore, mund të thuhet më e madhe se familja. Pra, i riu identifikohet me shoqërinë-grupin më të cilën jeton. Studimet që janë bëra konfirmojnë se miqësia u mundëson të rinjtë të krijojnë marrëdhënie ndër-personale në mënyrë miqësore anonime dhe jo të personalizuar. Sigurisht kjo nuk është një gjë negative, por nëse rinia mbështet vetëm në këto marrëdhënie atëherë ato mund të jenë të dëmshme për marrëdhëniet e mëtejshme jetësore. Shoqëria favorizon njohurinë më të thellë personale, lehtëson marrëdhë-

niet dhe ofron ndihmë në raste të vështira dhe në fund sjell një besim tek të rinjtë. Por këtu shtrihet pyetja: a janë miqësitë e të rinjve në të vërtetë autentike? Pra nga studimet e lartpërmendura është analizuar se miqësia e të rinjve është bërë vetëm në nivelin privat dhe për këtë nuk ndihmon të riun të ndërton një projekt të jetës në bashkësi.

5. Elementet konstitutive apo vlerësimi i zgjedhjes autentike

Kur personi vendos diçka, atëherë ai veprim nuk është vetëm shprehje e vullnetit apo përmblendje automatike e llogarive dhe dobeve, apo humbjeve që do t'i ketë apo jo. Pra ai nuk është vetëm një akt i shkëputur nga pjesët tjera, por është një person me intencionet, impulset, ndjenjat, idetë, përvojat që rrjedhin nga e kaluara dhe e orientojnë në të ardhmen.

Kur një person vendos diçka të rëndësishme në jetë, ai nuk luan me lirinë e vet, por shpeshherë ndoshta edhe ndien vuajtje të madhe për atë çka len pas dhe për atë çka dëshiron të ndërmarë. Por këtë e bën nga bindja apo vetëdija sado që e madhe apo e

posaçme mund të jetë pikë referuese antropologjia e cila e shikon njeriun si një proces në zhvillim i cili arrihet dita ditës apo udhëton drejt realizimit të një projekti jetësorë. Pra, psikologjia dhe degët e saj e shikojnë njeriun të aftë të ndërtojë një ardhmëri duke filluar nga ky projekt jetësor si qendër e unifikimit dhe integritetit të personalitetit. (Allporti- Eriksoni).

Për sa i përket thirrjes psikologjia ofron ndihmë që të reflektohet mbi thirrjen në tri fusha:

analizimin e motiveve, studimet dhe shkaqet e krizave vocazionale, studimet psiko-sociologjike mbi vlerat e thirrjes dhe gjeneratat e të rinjve.

6. Kriteret për vlerësimin e thirrjes

Të rinjtë duhet të edukohen në njohurinë më të hollësishme të vetvetes dhe motiveve personale. I riu duhet të ndihmohet dhe të shpëhet në një pjekuri ku ai vetë vendos dhe bënë zgjedhjet. Pranon të tejkalon edhe frustrimet si domosdoshmëri normale për një rritje të shëndosh. I riu duhet të edukohet në brendësi dhe dashuri dhe ta pranon jetën si dhuratë dhe detyrë në dritën e planit të Zotit. Për vlerësimin e një thirrjeje janë të nevojshme

kriteret si pozitive ashtu edhe ato negative. Në kriteret pozitive marrin pjesë: dispozitat që personi i ka, kualitetet, pjekuria dhe udhëtimi në fe. Në dispozitat që personi ka është më rëndësi fusha e pjekurisë njerëzore, (shëndeti fizik, pjekuria konjuitive, pjekuria afektive, pjekuria e autonomisë personale); pjekurisë së krishterë dhe atë në nivelin e eksperiencës së krishterë dhe jetës morale dhe atë të misionit, karizmës.

Kurse kriteret negative janë: kontrindikacionet dhe situatat problematike.

Qendër kryesore është analizimi i motiveve. Në rend të parë është me rëndësi t'i njohim, vlerësojmë motivimet që qëndrojnë në qendrën e zgjedhjes së thirrjes apo janë thellë i një zgjedhje. Nuk është fare lehtë të bëhet analizimi i motiveve. Për këtë nevojitet që të kemi kompetenca dhe metoda specifike, posaçërisht ti ndihmojmë kandidatit dhe ta shpiem që të zbulon motivimet e veta posaçërisht ato jo të vetëdijshme, dhe të deshifrojmë shenjat dhe treguesit tjerë të sjelljeve dhe qëndrimit të një të riu. Ta motivojmë dhe orientojmë që të bënë zgjedhje të lira dhe përgjegjëse. Ta aktivizojmë dhe promovojmë zhvillimin e thirrjes në persona, në atë mënyrë, që ai të bëhet subjekt aktiv, protagonist i zgjedhjeve. Ta udhëheqim dhe ta përkrahim në

udhëtimin e formimit që t'i ofrojmë caqe të reja formuese në një pjekuri personale dhe progresive dhe një integritet efikas në bashkësi në realizimin e detyrës apo misionit që iu është besuar. Sepse kjo nuk është vetëm një analizë psikologjike apo historike dhe biografike por analizimi duhet të inkadruhet në një perspektivë më të gjerë që ai/ajo të qartëson që është i thirrur /e thirrur për një jetë të tillë.

Pastaj është me rëndësi qëllimi i vërtetë dhe i singërtë dhe që personi të ketë motivim autentik. Është shumë me rëndësi se kandidati është i inspiruar nga shpirti i mirë. Zoti kryesisht vepron duke aktivizuar memorien, intelektin, vullnetin. Për një thirrje të kushtuar janë të rëndësishme edhe shenjat e kohës, sepse zëri i Zotit nuk arrin në veshët e të thirrurit në mënyrë të jashtëzakonshme. Por thirrja njihet dhe vlerësohet nëpërmes të atyre shenjave në të cilat shërbehet Zoti çdo ditë për të kuptuar vullnetin e Tij. Të zgjedhësh të bëhesh rregulltar i kushtuar Zotit është pra kërkim i vullnetit të Zotit. Çka do të thotë të zgjedhësh jetën e kushtuar: do të thotë të kërkoesh të evidentosh cili është vullneti i Atit që ka mbi ty dhe mbi secilin bij apo bijë të vetën, që e udhëheq dhe në mënyrë të plotë e realizon. Por vullneti i Zotit nuk mund të gjendet si një visar i fshehur njëherë e përgjithmonë, ai na zbulohet dhe për çdo moment të jetës sonë. Në këtë rrugë na nevojitet të bëjmë shoshitjen e thirrjes. Kjo mënyrë e shoshitjes është e nevojshme para hyrjes në një rregull apo Seminar, që të verifikohet më të vërtetë thirrja. Edhe pse ky proces është i nevojshëm të vazhdojë edhe gjatë tërë procesit të formimit, i cili zgjat tërë jetën. Shoshitja realizohet në kohë dhe nuk mund të kufizohet vetëm në një moment specifik, por aktualizohet në brendësinë e një udhëtimi formues, i cili realizohet në etapa dhe objektiva konkrete sipas ritmit të rritjes dhe pjekurisë personale e sipas dimensioneve të ndryshme (shpirtërore, psikologjike, ekzistenciale, afektive, relacionale).

Përfundim

Këtyre të rinjve që janë të ndjeshëm dhe problematikë, të pavendosur dhe shpesh të bllokuar në aftësitë e tyre të projektojnë një ardhmëri, Papa Gjon Pali II mori kurajë t'u ofrojë një propozim për një thirrje të fortë dhe të drejtuar në shenjtëri "Mos keni frikë të jeni shenjtë të Mileniumit të ri! Bëhuni sditës, ta doni lutjen, bëhuni koherent me fenë tuaj, zemërgjerë në shërbim të vëllezërve... ndërtesë të një humaniteti të ri". Të kemi kurajë edhe ne të bëhemi dëshmitarë të këtyre të rinjve në sditjen dhe shërbimin e vëllait njeri.



Domethënia e disa simboleve (e përgatitur enkas për fëmijë)

Vaji

Sa i madh është Zoti, që nëpërmjet gjërave më të thjeshta shpreh shenjat misterioze të pranisë së Tij. Medito: në objektet më të përbashkëta dhe të zakonshme, mund të zbulosh porosinë më elokumente të Hyjit. Edhe vaji është njëri ndër këto. Mendo një herë në përdorimin e shumëfish të vajt. Përdoret në kuzhinë për ushqim, përdoret si lëndë djegëse, shfrytëzohet në mënyra të ndryshme si terapi sidomos në fushën e kozmetikës e në sport. E do të vazhdonim...

Për të gjitha këto, dhe dobi tjera, vaji është bërë, qysh prej kohërave më të lashta, simbol i shëndetit, i mirëqenies, i paqes edhe të popullit hebre. Nuk dëshiroj të të mëzis duke i cituar tekstet që e konfirmojnë gjithë atë që po të them.

Po të lus që në veçanti të ndalesh në një lyerje të posaçme që ndodhte në zgjedhjen apo në shugurimin e mbretit, të kryepfritit apo të profetit. Pse një lyerje e tillë? Mendohej përpara

që vaji mbante në vetvete një energji të posaçme, fetare, ose të një natyre hyjnore. A e di se fjala Krisht rrjedh prej greqishtes dhe do të thotë "i lyer", dhe fjala Mesi rrjedh prej hebraishtes dhe e ka po të njëjtën domethënie? Do të më thuash: Por Krishti nuk është lyer me vaj! E vërtetë, nëse e marrim lyerjen në kuptimin fizik. Krishti e ka pranuar një lyerje jo fizike, po krejt të veçantë. Komenton një shenjtë: "Krishti nuk qe lyer me vaj ose me diçka materiale, por Ai qe lyer prej Atit me Shpirtin Shenjt".

Edhe të krishterët (*emrat e tyre do të thonë "të lyer"*) kanë pranuar dhe pranojnë gjatë jetës disa lyerje. Mendo në sakramentet. Në Pagëzim, meshtari e lye me vajin e katekumenëve dhe menjëherë pas pagëzimit e lye me vajin e Krizmës (*vaji i përzier me balsam aromatik*) kokën e të pagëzuarit. Në Krezmim, lyerja me vajin e Krizmës ndodh në ballë, ndërsa gjatë shugurimit meshtarak ipeshkvi i lye duart e në shugurimin e ipeshkvit, lyhet

koka e të shuguruarit. Dhe në fund e kemi edhe lyerjen e të sëmurve: lyhet balli dhe duart. Po e shtoj këtu edhe lyerjen e ballnikëve dhe të altarit me rastin e shugurimit të ndonjë Kisha.

Nuk guxoj të lë anësh edhe një detal: vajrat bekohen prej ipeshkvit gjatë meshës së të Enjtes së Madhe e quajtur pikërisht mesha e Krizmës. Pastaj nuk më mbetet tjetër, përveç se të shpjegoj edhe gjestin e lyerjes së kraharorit, kokës, ballin dhe duart.

Në pagëzim, lyerja me vajin e katekumenëve në gjoks të fëmijës, dëshiron të transmetojë forcën e Hyjit, atij që është duke e filluar jetën e re, një rrugë vërtet e vështirë. Qysh prej kohërave më të vjetra atletët dhe luftëtarët lyeshin me vajra të ndryshëm për t'u përgatitur për luftëra dhe për sforcime eventuale. Lyerja me vajin e Krizmës, pas pagëzimit, e ka një domethënie tjetër: shënon një kushtim të plotë Jezu Krishtit. Të kalojmë në sakramentin e Krezimit apo të



Përformimit: gjesti kryesor është shenja e kryqit në ballë. Fjalët që ipeshkvi i thekson, shpjegojnë edhe kuptimin e gjestit: "merre vullën e Shpirtit Shenjt që të është dhuruar". Shenja në ballë tregon se i krezmuari i takon tashmë Krishtit dhe këtë duhet ta dëshmojë haptas. Në sakramentin e vajimit lyhen balli dhe duart: balli dhe duart kanë kuptimin e tërësisë së personit që merr forcë dhe ngushëllim shpirtëror prej Zotit. Në shugurim lyhen duart dhe për ipeshkvi lyhet kryet: duart duhet të shpërndajnë Hirin

e Zotit, të transmetojnë mëshirën e Zotit; koka paraqet autoritetin e ipeshkvit si bari dhe drejtues i bashkësisë.

Në fund një saktësim: vaji i Krizmës, si kur të kam thënë edhe më parë, është vaji i përzier me balsam aromatik. Nëse vaji hyn në porët e trupit tonë, dhe për këtë arsye simbolizon veprën e Shpirtit Shenjt që e arrin edhe thellësinë e qenies sonë; ndërsa aroma që del përjashta dhe të tjerët e përjetojnë, tregon gjithashtu edhe efikasitetin e Shpirtit Shenjt përjashta dhe ndaj të afërmit.

Buka e vera (ushqimi dhe pija)



Po të flas tani për bukën dhe verën. Sikur po e sheh, nuk i kam emëruar ndarazi. Arsyja do të jetë e qartë vetëm në fund të këtij meditim. Edhe tek religjionet tjera gjejmë dreka apo ushqime (*tryeza*) të shenjta (në nder të të vdekurve apo të ndonjë hyjnie), por në asnjë religjion tjetër nuk i jepet rëndësi ushqimit dhe pijes sikur tek ne. Në çfarë kuptimi?

Të konsumosh bukën dhe verën është një gjest shumë njerëzor. Pikërisht për këtë gjë, edhe Krishti, për efikasitetin e shprehjes dhe meqenëse është në përdorim të të gjithëve, e ka zgjedhur si shenjë mbinatyrore, të dhurimit të Trupit dhe të Gjaku të vet.

Para së gjithash, dua të flas për bukën. Prej se bota është botë, të emërosh bukën do të thotë të flasësh për ushqimin kryesor të njeriut. Për mbijetesën e tij. Kur e dëgjon dikë duke folur "Ai nuk ka për të ngrënë", mendon menjëherë në bukën. Sa herë e ke dëgjuar

fjalinë "të fitosh bukën me djersën e ballit": do të thotë të punohet seriozisht për të mbijetuar. Tek popujt e vjetër buka ishte aq e çmuar sa që konsiderohej si dhuratë e hyjnine.

Siç mund të shohësh, buka mban në vetvete një laramani simbolesh dhe kuptimesh. Po e përmend atë kryesorin. Tek hebrejtë buka e kishte kuptimin e çdo ushqimi të trupit dhe të shpirtit. Buka e kishte kuptimin edhe të falës së Zotit. Të kujtohet përgjigja që Jezusi ia jep djallit (*Mt 4,4*) duke i marrë fjalët e nxjerra nga libri i ligjit të përtërirë: "Jo vetëm prej buke jeton njeriu, por prej çdo fjale që del nga goja e Hyjit" (*Ligji 8,3*).

Po kaloj tani të flas pakëz edhe për verën: nuk është pija që e largon etjen sikurse është uji. Vera, thotë Shkrimi Shenjt, e gëzon zemrën e njeriut (*Sir 31,28*). Mund të themi pra që është pije gëzimi: shpreh plotësinë, bollëkun e jetës. Për këtë arsye, vera tek hebrejtë ishte simbol i lumturisë,

i prosperitetit dhe i pjellshmërisë. Në asnjë banket nuk guxonte të mungonte një kupëz me verë dhe një lutje falënderimi. Mendo në darkën e Pashkëve, gjatë së cilës edhe sot hebrejtë e kalojnë tri herë secilit prej të pranishmëve kelkun me verë, në një atmosferë gëzimi dhe bekimi hyjnor. Mos e harro edhe episodin e Kanës së Galileës, kur Jezusi e shndëroi ujin në verë për të evituar situata të papërgjeshme për mungesë të verës (*shiko Gj 2, 1-11*).

Vera flet për miqësi e bashkim me të tjerët. Mendo se çka do të thotë të pish ndonjë gotë, apo të gëzohesh për një festë apo fitore. Bibla thotë se miku i mirë është sikur vera e mirë (*Sir 9,10*). Vera është simbol i dashurisë dhe i urtisë.

Për hebrejtë vera thërriste në veçanti ardhjen e Mesisë. A e di se për të definuar kohët e shpëtimit dhe të ardhjes së Mbretërisë së Hyjit, shpeshherë shkohet në figura të banketit, ku nuk mungonin aspak edhe vera të shkëlqyera. Në fund edhe Jezusi ka afirmuar të jetë edhe hardhia e vërtetë (*Gj 15, 1-17*).

Nëse tani i konsiderojmë së bashku bukën dhe verën, mund të zbulojmë edhe domethënie të tjera. Një në veçanti. Ti e di se buka rrjedh prej miellit, i cili vjen prej shumë kokrrave të grurit, të bluara e të pjekura më në fund; vera është prej shumë kokrrave të rrushit të shtypur dhe të përgatitur mirë. Bashkësitë e para shikonin në këto përbërje

simbolin e bashkimi të kishës. Sikur shumë kokrra gruri bëjnë një bukë të vetme, sikur shumë kokrra rrushi një verë të vetme, kështu edhe Kisha, e përbërë prej shumë anëtarëve, bën një të vetmen bashkësi.

Tani duhet të them edhe gjënë më të vështirë: mendo në të gjitha ato informata që t'i kam dhënë paraprakisht për sa i përket bukës dhe verës dhe medito: a do të kishte mundur Zoti të zgjedhë diçka më të mirë për të komunikuar vlerën e jetës së vet? Ai i ka marrë dy elemente (*nuk po them më të rëndësishmit nga se uji do të ishte më i rëndësishëm se vera*), por dy elementet sigurisht më të plotë që ekzistojnë në dhe e i ka bërë shenja të pranisë reale të Tij: "Ky është Korpi im...Ky është Gjaku im..." (*Mt 26, 26-29*).

Sigurisht, që është një mister aq i madh sa që nuk ekzistojnë edhe fjalë të përshatshme për ta shpjeguar: por duhet besuar me gjithë zemër!

Gjëja e fundit. Të krishterët e parë, për të treguar Sakramentin e themeluar prej Jezu Krishtit, në darkën e fundit, përdornin shprehjen: "Ndarja apo thyerja e bukës", prej vetë gjestit të thyerjes së bukës. Më vonë erdhi edhe shprehja "Eukaristia" (*lutje falënderimi*). Vetëm në kohët e mëvonshme u përhap buka shekullit IX erdhi tradita të jetë buka e pabrume. Ndër tjerat, edhe kjo është një traditë shumë e vjetër dhe e përhapur tek hebrejtë. Këtu kemi të bëjmë me një pjesë të bukës, e rrumbullakët, e hollë, që quhej Hostie dhe që do të thotë sakrificë, apo flijim. Ndërsa përdorimi i Hostieve që jemi mësuar të përdorim, u përhap vetëm pas shekullit XI, kur edhe mbaroi për besimtarët kungimi apo bashkimi edhe në kelkun e verës.

gabimisht, "shkoni, mesha u krye". "Missa" në latinisht është folje, e prandaj subjekti nënkuptohet. Pra do të ishte kështu: "shkoni, takimi, apo asambleja është zgjidhur". Por një studiues tjetër preferon mundësitë tjera më interesante. Subjekti i nënkuptuar nuk do të ishte, sipas tij, asambleja, por Eukaristia. Atëherë do të mund të përkthenim: "mund të shkoni, Eukaristia është dërguar". Kujt? Përpata, në Romë, në fund të lutjes eukaristike, këta e shuguruar, ndahej dhe nëpërmjet xhakonëve dërgohej në Kisha tjera ose personave që nuk ishin të pranishëm sikur të sëmurit ose të burgosurit.

Një kuriozitet. Çfarë buke përdornin të krishterët e parë për të kremtuar Eukaristin? Përdornin bukë të thjeshtë dhe të zakonshme, në formë të rrumbullakët, mbi të cilën gjendej i vizatuar një kryq. Vetëm pas shekullit IX erdhi tradita të jetë buka e pabrume. Ndër tjerat, edhe kjo është një traditë shumë e vjetër dhe e përhapur tek hebrejtë. Këtu kemi të bëjmë me një pjesë të bukës, e rrumbullakët, e hollë, që quhej Hostie dhe që do të thotë sakrificë, apo flijim. Ndërsa përdorimi i Hostieve që jemi mësuar të përdorim, u përhap vetëm pas shekullit XI, kur edhe mbaroi për besimtarët kungimi apo bashkimi edhe në kelkun e verës.

(Përkthet nga italishtja:
Don Jeton Thaqi)



Ti që e do Nënë Terezën dhe ndërtimin e Katedrales, uroje, ndihmoje, realizoje, duke thirrur në numrin

0900-901-101

Çdo thirrje e jote të kushton një euro.

**TA NDIHMOJMË
NDËRTIMIN E KATEDRALES**

*Jam mik i Kishës Katolike
dhe dua ta ndihmoj
ndërtimin e Katedrales
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bamirës
të dashur, ju mundësojmë ta
jepni kontributin përmes
xhirollogarive bankare.

Faleminderit!

Raiffeisen BANK
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

**Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:**
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

ABONONI "DRITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë "Drita". Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë** "Dritën" (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë:
Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.

Emri: _____
Mbiemri: _____
Adresa: _____
Qyteti: _____
Kodi postar: _____
Numri i telefonit: _____
E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.

DRITA

E PËRMUAJSHME PETAJE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Tetos 2009 • Viti XXVI • Nr. 10 (total) • Çmimi: Kuvendi i Evropës, Zëri i Evropës, SHERA 2010

**si ato kaloni
të emergjencës,
realizimi dhe
përfundimi**

**si ato kaloni
të emergjencës,
realizimi dhe
përfundimi**

**si ato kaloni
të emergjencës,
realizimi dhe
përfundimi**

**Zgjedhjet - detyrë, mundësi dhe
përgjegjësi qytetare dhe morale**

Mos, Shkëlqim, Shkëlqim

**Familja Albani,
kater shekuj
shkëlqim historik**

**Atërin i qytetërimit
përmes krijtarisë
kinematografike**